



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **Procesverbal nga mbledhja e XLVI-të (dyzetegjashtë)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 11 dhjetor 2024.**

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; kurse munguan Fitim Muçolli; Lirika Maliqi.

(Nga LDK Valon Demolli; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani, kurse mungoi, Arnisa Sylejmani.

Nga PDK, Bashkim Sylaj; Mimoza Abdullahu; kurse mungoi Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi.

Të pavarur, Adnan Zymeri, kurse mungoi Demokrat Hodolli.

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, znj.Marigona Lahu Nënkryetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Vlora Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Shujb Blakçori-Drejtorja e Inspeksionit DI dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Administratës DA; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm ishin edhe, Kovacs Karoly dhe Moluatom Balazs përfaqësues të KFOR – LMT; Samir Calakoviç përfaqësues i OSBE; media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

## Rendi i Ditës

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj punë të mbarë, ndër të tjera theksoi, për momentin të pranishëm në mbledhje janë 28 anëtar/e të Kuvendit të Komunës, kurse për momentin mungojnë Fitim Muçolli; Lirika Maliqi; Arnisa Sylejmani; Endritë Murati; Mimoza Abdullahu; Gazmend Islami; dhe Demokrat Hodolli i cili është i vetmi i cili më ka njoftuar që nuk mund të jetë sot prezent në mbledhje, andaj kuorumi ekziston dhe mund të vazhdohet me punimet e Kuvendit mirëpo para se të fillojmë me rendin e ditës, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.

**znj.Arjeta Abazi**, deklarim, theksoi, e nderuar Nënkryetare e Komunës, Kryesues i Kuvendit dhe ju koleg asambleistë, të dashur qytetarë, unë sot po ju drejtohem jo për të diskutuar për punimet e kësaj seance e as për të propozuar ndonjë pikë të re të rendit të ditës, por t'ju njoftoj e falënderoj për kolegialitetit, punën dhe angazhimet e përbashkëta në Kuvendin e Komunës së Podujevës gjatë tri viteve që po lëm pas.

Besoq që shumë nga Ju tani më e dini që jam nominuar nga dega e Lidhjes Demokratike e Podujevës kandidate për Deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, andaj unë sot kam vendosur të tërhiqem nga të qenit anëtare e Kuvendit të Komunës së Podujevës, kjo me qëllimin më të mirë që të mos duplikoj pozicionet institucionale dhe t'i përkushtohem garës për një përfaqësim në nivel qendrorë, pra në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Zotohem edhe nga kjo foltore para gjithë atyre që më besuan dhe nderuan me votën dhe besimin e dhënë për mundësinë që t'i përfaqësoj në Kuvendin e Komunës së Podujevës se do të jem përherë dhe kudo zëri i tyre në secilin angazhim dhe përgjegjësi që unë do të mbajë, pra gjithmonë përkushtimi ndaj juve do të jetë i rëndësishëm së veçantë në rrugëtimin tim politik.

Ky vendim sigurisht që nuk është i lehtë për mua sepse bashkë me kolegë kemi adresuar tema të rëndësishme për qytetarët, por këtë vendim e bën të lehtë pasuesja ime në këtë Kuvend që do të jetë Qëndresë Haliti e cila me forcën dhe dashurinë për jetën u ka bërë ballë shumë sfidave.

Edhe njëherë faleminderit të gjithëve duke ju dëshiruar punë të mbarë dhe suksese.

**z.Qëndrim Softolli**, deklarim, theksoi, e nderuar Nënkryetare e Komunës, Kryesues i Kuvendit, Ekzekutiv i Komunës, të nderuar kolegë/e asambleistë dhe shumë të dashur qytetarë, ka qenë një nderë dhe privilegj për mua të shërbej për dy mandate në këtë Kuvend të Komunës së Podujevës ku gjatë këtyre viteve ne kemi përballuar sfida të shumta dhe kemi diskutuar tema të shumta dhe kemi marrë vendime të rëndësishme që kanë pasë inpakt të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve, çdo vendim që kemi marrë ka qenë i orientuar me një qëllim të qartë, përmirësimin e jetës së komunitetit.

Sot dëshiroj t'ju njoftoj se do ta liroj këtë pozitë për tu përkushtuar për një mundësi të re në garën për Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës pas nominimit dhe nderit që më është dhënë nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Ky është një vendim i rëndësishëm, për mua si në aspektin personal ashtu edhe në aspektin politikë, por zotohem se do të vazhdoj e do të mbetem i përkushtuar të jap një kontribut të vlefshëm edhe në nivel nacional.

Të dashur qytetarë ju falënderoj nga zemra për besimin dhe mbështetjen e juaj të vazhdueshëm dhe pres me padurim që bashkëpunimi ynë të vazhdoj edhe në forma të reja në të ardhmen, kurse juve të nderuar kolegë ju uroj të gjithëve sukses në punët e juaja dhe shpresoj të shohë më të mirën për Komunën tonë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, falënderoj dy anëtarët parafolës të Kuvendit të Komunës znj.Arjeta Abazi dhe z.Qendrim Softolli për angazhimin e dhenë në Kuvendine Komunës së Podujevës dhe i'u uroj sukses në garën për Deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

*(Pas deklarimeve të znj.Arjeta Abazi dhe z.Qendrim Softolli për heqje dorë nga funksioni anëtar/e në Kuvendin e Komunës së Podujevës, të përmendur duke u përshëndetur me anëtarët/et e Kuvendit, Ekzekutivin e Komunës dhe stafin tjetër komunal prezent në sallë, lëshojnë sallën duke mos dashur të jenë pjesë e mbledhjes pas deklarimeve që bën).*

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, më lejoni që si pikë të rendit të ditës për këtë mbledhje të propozoj pikën e paralajmëruar në seancën e kaluar që është; Parandalimi i fenomeneve negative te adoleshentët dhe të rinjtë në Komunën e Podujevës

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi,

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 26 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, mbështet propozimi i z.Ragip Fetahut për përfshirje si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës edhe:*

**- Diskutim për parandalimin e fenomeneve negative të adoleshentëve dhe të rinjve në Komunën e Podujevë.**

*(renditet pikë e 7 e rendit të ditës)*

**z.Valon Demolli**, theksoi, fillimisht dy kolegëve të cilët japën dorëheqje i'u dëshiroj suksese.

Propozoj një pikë shtesë për rend të ditës për këtë mbledhje, ndërrimin e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa pasi që siç e dim ka qenë z.Qendrim Softolli, andaj kërkoj të futet në rend të ditës si pikë shtesë plotësim ndryshimi i përbërjes së KPF-së, përkatësisht zëvendësimi i anëtarit të cekur.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, pra pa vonesë e hedh në votim propozimin e parafolësit që të përfshihet në rendin e ditës si pikë shtesë për këtë mbledhje.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 25 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 15 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan) mbështetet propozimi i z.Valon Demollit për përfshirje si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës edhe:*

**- Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht zëvendësimi i anëtarit pas dhënie së dorëheqjes së z.Qendrim Softolli.**

*(renditet pikë e 8 e rendit të ditës)*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani nëse nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së si dhe dy pikat shtesë të mbështetura paraprakisht.

*Pas votimit kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 25 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, konstatimeve nga mbledhje e KPF-ës si dhe me plotësimin edhe me dy pika shtesë të mbështetura paraprakisht.*

### Pikat e rendit të miratuar të ditës

1. *Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 12 shtator 2024; 26 shtator 2024 dhe 04 nëntor 2024*
2. *Propozim vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës*
3. *Draft Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës, për vitin 2025*
4. *Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025*
5. *Informatë e Punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, korrik-nëntor 2024*
6. *Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*
7. *Diskutim për parandalimin e fenomeneve negative të adoleshentëve dhe të rinjve në Komunën e Podujevës*
8. *Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht zëvendësimi i anëtarit pas dhënies së dorëheqjes së z. Qendrim Softolli*
9. *Të Ndryshme*

### **1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 12 shtator 2024; 26 shtator 2024 dhe 04 nëntor 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, pra kemi tri procesverbale nga tri mbledhje të kaluara të Kuvendit, meqë mbledhje kanë qenë mbajtur nga me njëra tjetrën nuk kanë mund të përgatiten më herët, mirëpo tani nga zyrtarët përkatës janë përgatitur këto tri procesverbale dhe ju janë dërguar me materiale e kësaj mbledhje. Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtyre procesverbaleve, nëse jo i hedh në votim në pako sipas materialit përkatës të dërguar.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 25 vota Për nga anëtarët e Kuvendit sa ish-in prezent në sallë, miratohen 3 procesverbalet sipas kësaj pike të rendit të ditës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

### **2. Propozim vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, në këtë pikë kemi të bëjmë me propozim vendimin për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës, pikë kjo e cila është diskutuar gjatë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa. Është një kërkesë e bashkësisë Islame që i është bërë Komunës së Podujevës, mirëpo në mbledhjen KPF-ës janë dhënë disa vërejtje dhe ka pas disa kërkesa nga anëtarët e Komitetit që në shërbimet që i kryen Bashkësia Islame ndaj qytetarëve në ditën e varrimit të hyjë edhe hapja e varrit, mirëpo kjo kërkesë nuk është pranuar nga Bashkësia Islame dhe sot na janë drejtuar me një shkresë të cilën po e lexoj tani meqë nuk e posedoni në materialet e dërguara, pra në materialin e dërguar më parë për këtë mbledhje ka qenë propozim vendimi përkatës së bashku me materialin përcjellës, kurse në mbledhjen e KPF-së është kërkuar që në kuadër të shërbimeve që i kryen Bashkësia Islame të hynë edhe hapja e varrit sepse nuk është paraparë deri tani, kështu që Bashkësia Islame sot me një shkresë na është drejtuar neve si Kuvend dhe Kryetarit të Komunës, rreth idesë për shërbime shtesë, dhe në vijim po e lexoj;

*Të nderuar lidhur me propozimin e dalë nga Komiteti për Politikë dhe Financa që krahas shërbimeve të varrimit të shtohet edhe rrëmihja e varrit, ne si Bashkësi Islame në Podujevës ju informojmë se e kemi të pamundur marrjen përsipër të rrëmihjes së varrit. Një gjë të tillë e konsiderojmë si mjaftë të ndjeshme dhe delikate, mes tjerash edhe për arsye si në vijim;*

*1-ekzistimi i shumë lokacioneve të varrezave e që Komuna jonë ka 78 fshatra dhe ka raste ku në të njëjtin fshat ekzistojnë shumë varreza,*

*2-largësia ndërmjet varrezave dhe terrenet e papërshtatshme ku ka fshatra deri në 15 lokacione të varrezave,*

*3-zakonisht ekzistojnë më shumë se një vegël e punës dhe kur kësaj i shtojmë faktin e lokacioneve të ndryshme të varrimit e bën të vështirë marrjen me këtë detyrë për ne,*

*4-shumë prej familjeve banorë në qytet varrimet e familjarëve i bëjnë nëpër fshatrat e origjinës,*

*5-në shumë mese familjare hapja e varrit konsiderohet si shërbim që duhet ta bëjë farefisi për të vdekurin,*

*6-një shërbim të tillë ne si institucion i Bashkësisë Islame nuk posedojmë fuqi punëtore, staf, makineri, mjete pune për këtë shërbim shtesë.*

*Pa modesti ju informojmë se ne si Këshill i Bashkësisë Islame të Podujevës kryejmë shërbime në nivelin më të lartë në nivel vendi, vlerësim i cili ka ardh edhe nga vet qytetarët në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, andaj së këndejmi shtimi i këtij obligimi do të krijonte obligime direkte në mbarëvajtjen e shërbimeve të varrimit në terren.*

*Ju faleminderit për mirëkuptim.*

Pra ky ishte arsyetimi i Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kësaj çështje, urdhëroni e hapi debatin.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSH dhe i autorizuar për dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM, theksoi, fillimisht rregulli është që t'i jepet fjala drejtorit të Drejtorisë përkatëse për të paraqitur hyrjen dhe sqarimet e nevojshme e pastaj asambleistëve mirëpo meqë ti Kryesues i the të gjitha dhe e lexove shkresën e Këshillit të Bashkësisë Islame atëherë unë nuk kam çka diskutoj në këtë fazë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ne propozimin e Kryetarit të Komunës e kemi pranuar me kohë të gjithë dhe e kemi diskutuar edhe në KPF këtë çështje, pra materialin e Kuvendit e kanë të gjithë. Po ashtu unë e lexova edhe shkresën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë e cila na është dërguar sot neve si Kuvend dhe Kryetarit të Komunës, përndryshe nëse dëshiron fjalën urdhëro i nderuar drejtor i DSHPMSH.

**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, unë kërkova fjalën i parë dhe në emër të Grupit më të madh dhe u dashtë të më jepet fjala, andaj nuk e di përse kështu veproje, a ke ndonjë hatër mbetje apo.

**Kryesuesi i Kuvendit**, duke i'u përgjigjur parafolësit theksoi, të vetmen hatër mbetje që e kam është që nuk e ke ngritur dorën i pari por e ngriti z.Naim Çunaku.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, me gjithë respektin për parafolësin zotëri Maloku të cilit veç i thash të vazhdoj me diskutimin, por u krijua siç u krijua situata dhe po besoj se nuk ka ndonjë të keqe të vazhdohet me diskutim nga ana ime, andaj edhe po vazhdojmë ashtu siç e kërkua fjalën.

Një ditë më parë në mbledhjen e KPF-së e biseduam këtë temë që jashtëzakonisht pajtohëm se është një temë e ndjeshme dhe që ka inpakt të drejtpërdrejtë në ditët më të vështira që na ndodhin në familjet tona dhe kur është mënuar ky projekt i cili është projekt në vazhdim, në kuptimin e vlerësimit të asaj dite që kur na ndodhin raste në familjet tona që të ndahemi nga më të dashurit tanë po ofrohet ky shërbim, dhe për këtë qëllim është bërë ky bashkëpunim përmes Memorandumit të Bashkëpunimit të Komunës me Bashkësinë Islame. Pra në mbledhjen e KPF-së e diskutuam këtë çështje dhe atë që e kam potencuar në atë mbledhje po mundohem të paraqesë edhe këtu sot.

Qysh prej fillimit të jetësimit të këtij Memorandumi, unë në veçanti personalisht po e them, më se 3-4 herë nga kjo foltore e kam përfolur dhe se mendoj ashtu që një prej arsyeve dhe një prej lehtësimeve më të mëdha që mund t'i bëhet atë ditë një familjari që ka pas një rast të vdekjes, të gjithë këtu po jetojmë dhe vërejmë mangësinë e fuqisë punëtore e që e kemi bajagi të vështirë në atë periudhë të caktuar kur diçka që për herë të parë të shkon në mendje ta njoftoj Bashkësinë islame në mënyrë që të merre në dorë gjithë këto praktika që ne i kapërcejmë, pastaj te Bashkësia Islame përmes telefonatës kërkohet në rend të parë pagesa e anëtarësisë dhe prej gjindshmërisë tënde dhe akraballëkut që më bëri përshtypje shumë tek pika 5 e kësaj kërkesë të Bashkësisë Islame që e paskan futur edhe një diçka e që është, “as sevap e as gjynah” po foli me fjalorin e fesë, u tha se është e preferuar që rrëmihjen e varrit ta bëjnë farefisi, e që nuk e di ku e kanë gjete këtë, ose një arsytim që atyre i'u është dukur i arsyeshëm, nuk kemi makineri, por unë e di që Bashkësia Islame as makineri për përpunimin e drurit nuk kanë sepse aty janë ajo pjesa e dërrasave apo e sanakut, mirëpo për krejt këtë dje në KPF ka qenë propozim i imi por që edhe më parë ka qenë propozim dhe i falënderoj gjitha ata që e mbështeten sepse unë konsideroj që nëse ne sot dëshirojmë ta ndihmojmë një familje e cila në momentet e caktuara të vështira që i kalon me rastin e vdekjes së familjarit të tyre, do të ishte kryesorja dhe parcialja që ne nëse e ndihmojmë në rrëmihjen e varrit, dhe këtë e kemi menduar ne si përfaqësues të qytetarëve dhe atyre familjeve që të shqyrtohet mundësia dhe kështu ka qenë propozimi i nderuar Kryesues i Kuvendit, të shqyrtohet mundësia që marrëdhëniet kontraktuale për këtë Memorandum i cili ka ekzistuar prej vitesh, t'i shtohet edhe mundësia e rrëmihjes së varrit nga kontraktuesi në këtë rast ose me atë që kemi bërë Marrëveshje që është Bashkia Islame.

E diskutuam edhe dje në KPF që kemi praktika në Komunat tjera, shembull në Prishtinë në një kohë rrëmihjen e varrit e ka bërë Ndërmarrja “Pastrimi”, dhe si solucion për të dalë nga kjo, e kam thënë dje dhe po e them edhe sot që ka, vetëm a ka vullnet sepse mund të gjendet forma që mund të jetësohet ky projekt.

Siç e dini të gjithë ne kur e kemi themeluar organizatën komunale “Eko-Llapi” e kemi menduar që “Eko-Llapi” do të jetë ai i pari që do të ofroj shërbime si organizatë e jona, fundja unë mendoj që duhet të shqyrtohet mundësia që në të ardhmen të bëjmë një marrëdhënie kontraktuale me “Eko-Llapi” dhe shpenzimet, përjashto ritet fetare që janë të Bashkësisë Islame, këtë pjesën tjetër nëse nuk ka gatishmëri Bashkësia Islame ta kryej, atëherë mund të shqyrtohet si mundësi, si solucion që këtë shërbim ta kryej “Eko-Llapi”.

Asnjë tendencë dhe asnjë politizim sepse vdekja nuk ka numra, nuk ka ngjyra, nuk ka germa, por e kemi të gjithë dhe do ta kemi deri sa të jemi në këtë botë, me këtë qëllim ishte që nëse vërtetë që nëse dëshirojmë ta ndihmojmë, po shihet që ashtu siç e përmendi edhe Kryesuesi i Kuvendit me statistikë që në Komunën tonë ndodhin 2 vdekje brenda ditës, na bie që një organizatë e tillë, sepse unë di që Bashkësia Islame nuk ka kapacitete, por për ato kapacitete ne jemi këtu dhe atë jo për të thënë nuk ka por për t'i ndërtuar, sepse fundja Kuvendi i Komunës merr vendime për një të ardhme, dhe një e ardhme më e lehtë, më e mirë dhe më lehtësuese për ato ditë të vështira që përjetojnë familjet tona, kish me qenë edhe kontributi gjegjësisht marrja përsipër e një organizate, OJQ-je apo qysh do qoftë dhe ta bëjmë edhe pjesën e rrëmihjes së varrit si pjesë obligative të kontraktuar nga Komuna. Atëherë mendoj që ne e kemi marrë një vendim të plotë e jo sikurse tani që e konsideroj vendim të mangët nëse nuk e kemi të kontraktuar edhe rrëmihjen e varrit.

Bashkësia Islame me kërkesën që i është drejtuar, ne edhe dje e patëm, respekt për Bashkësinë Islame, por sa e lexova unë kërkesën, Kuvendi i Komunës vetëm vendim merr kurse nuk hyn në marrëdhënie kontraktuale apo nuk negocion marrëveshje me askënd, prandaj i nderuar kryesues ajo shkresë ishte më shumë e drejtpërdrejtë e organeve Ekzekutive në këtë rast Zyrtarit Kryesor

administrativ që është Kryetari i Komunës, dhe nuk pati një propozim konkret dhe në një formë mu duk që e kanë bërë një shkresë për të cilën nuk po them se ishte kërcënuese, nuk po e them arsyetuese, por që ne i marrim vetëm këto që neve mund t'i kryejmë ose që na konvenojnë, si të duash, por kompletimi se edhe ditën Komuna jonë me ngritje dore të këtij Kuvendi, të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës e marrin që Komuna e Podujevës me vendim Kuvendi ka marrë përsipër shlyerjen e obligimeve gjegjësisht kostos së varrimit, dhe ne e kemi këtë por faktikisht nuk po jua përmbushim ashtu siç po themi dhe mendoj që të shqyrtohet.

As nuk po aludoj që të mos votohet sepse edhe ashtu e përkrahim sepse nuk mund të mos përkrahet mirëpo gjithsesi mendoj që kish dashtë që pjesë e kësaj marrëveshje të jetë edhe hapja gjegjësisht rrëmihja e varrit për të vdekurit në Komunën e Podujevës.

**z.Haki Rudari**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së natyrisht se do ta paraqet diskutimin kolegu në vijim dhe e ka përkrahjen e gjithë Grupit, mirëpo deshta të bëjë dy ndërhyrje; 1-në këto raste kur kemi pika të rendit të ditës fillimisht fjala i'u jepet drejtorëve të Drejtorive e që e njëjta praktikë është edhe në nivel qendrorë ku fjala i'u jepet Ministrave, për arsye se këto që i potencoj kolegu parafolës natyrisht se drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit ndoshta ka për të dhënë sqarime më shumë, fundja te propozim vendimi, neni 6 ndër të tjerash po citoj, për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, dhe 2-me gjithë respektin për kolegun parafolës z.Naim Çunaku për të cilin kam respekt por që kundërshtimet politike janë tjera, mirëpo Grupeve më të mëdha politike gjithherë i'u është dhënë fjala, pra kur ka qenë LDK Grup më i madh politik gjithherë i është dhënë fjala të parës dhe asgjë nuk ka të keqe, prandaj i nderuar Kryesues në këtë drejtim është mirë të respektohet.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, zotëri Rudari, për praktikën në Kuvendet Komunale besoj se ndoshta edhe jemi ti dhe unë prej njerëzve që më së shumti kemi kaluar kohë në bankat e këtij Kuvendi, mirëpo qysh në fillim unë edhe e ngrita dorën i pari dhe Kryesuesi i Kuvendit natyrisht që nëse ti nuk e ngrit dorën nuk mund të të pres por i'a jep atij që e ka ngritur dorën, mirëpo fare nuk e kam telashe atë punë dhe madje po më duket krejt e panevojshme se kujt i është dhënë fjala të parit.

Unë më shumë e ngrita dorën në kuptimin e asaj që u lexua ajo shkresë këtu dhe në kuptimin që kemi debatuar një ditë më parë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, jo diçka që pata ndonjë hatër mbetje.

Sa i përket asaj që drejtori i Drejtorisë përkatës duhet ta merre fjalën, me gjithë respektin por propozuesi i vendimit e merr fjalën i pari, dhe propozuesi i vendimit në këtë rast goxha i panjohur është bërë, janë goxha të gërshetuar kush, tek, si.

**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, asgjë nuk pata me parafolësin z.Naim Çunaku sepse shumë mirë ishte edhe ai, mirëpo krejt problemin e pata tek Kryesuesi i Kuvendit sepse dora është ngritur por siç e ceku edhe z.Haki Rudari së pari fjalën e merr drejtori i drejtorisë përkatëse e pastaj Grupi më i madh parlamentar, mirëpo si do lqoftë po vazhdoj me fjalimin tim lidhur me këtë pikë.

Propozim vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës, është vendim shumë i nevojshëm duke pasë parasysh se mbështet familjet në momentet kur ata kanë më së shumti nevojë.

Një bashkëpunim i tillë në mes Komunës dhe Bashkësisë Islame si dhe çfarëdo qoftë institucioni gjithmonë kur është në dobi të qytetarëve është i mirëseardhur, andaj në emër të grupit të LVV-së e mbështesim këtë propozim vendim.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, u diskutua shumë këtu për shumë çështje që kanë të bëjnë me këtë temë që na është prezantuar neve. Edhe dje në mbledhjen e KPF-së ne kemi diskutuar për një dakordim i të gjithëve që ka qenë për të shkuar një rekomandim që në të ardhmen të diskutohet për këtë pjesën e varrimit sepse në rast se nuk kemi marrëveshje me Bashkësinë Islame ne kot e futim këtu

sepse nuk ka mjete dhe nuk kryhet ajo punë, dhe unë mendoj se krejt procesi shkon duke u bllokuar. Kështu që ne jemi që ta miratojmë këtë propozim vendim për t'i subvencionuar shpenzimet e shërbimit të varrimit për qytetarët e Komunës së Podujevës si dhe rekomandimi i kolegut z.Naim Çunaku ka qenë që në të ardhmen Komuna e Podujevës të gjen formë për një marrëveshje ose me Bashkësinë Islame ose me ndonjë subjekt tjetër për këtë pjesën tjetër që është pjesa e varrimit (hapjes së varrit), kështu që asgjë të paqartë nuk ka pasë në këtë çështje.

**z.Burim Hasani**, theksoi, sa i përket propozim vendimit për Propozim vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit tek qytetarët me vendbanime të ndryshme në territorin e Komunës së Podujevës, edhe ne si subjekt politik (AAK) kemi pasë një kërkesë nga Bashkësia Islame për rritjen e tarifës, faktikisht për shërbimet e një varrimi shpenzimet janë qenë 220 euro mirëpo në bazë të kërkesës Komuna e Podujevës ka rritë këtë tarifë në 250 euro. Kërkesa nga Bashkësia islame ka qenë që vlera të rritet në 300 euro edhe pse një kërkesë e qëllimit të mirë kjo por duke pasë parasysh ofertat dhe shërbimet që po i ofron Bashkësia Islame nuk korrespondon me këtë çmim. Unë sa i përket kësaj çështje, e potencoj edhe kolegu parafolës z.Naim Çunaku, kjo vlerë e cila ka kaluar nga 220 euro në 250 euro, kurse për pjesët tjera të ceremonisë së varrimit që kryhen nga Bashkësia islame besoj se është e nevojshme për atë pjesë, kurse sa i përket hapjes së varreve, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera besoj se Komuna do ta ketë një përkrahje për Bashkësinë Islame përmes Ndërmarrjes Publike edhe pse Komuna e Podujevës këtë proces veç e ka filluar, fillimisht me pastrim kurse besoj shumë që edhe unë si përfaqësues dhe aksionar në Ndërmarrjen Publike do të bëjë një kërkesë në lidhje me atë që Ndërmarrja Publike, me Komunën e Podujevës të ndaj mjete buxhetore dhe në koordinim me Bashkësinë Islame, Komunën e Podujevës dhe Ndërmarrjen Publike që të ofroj këtë shërbim që është hapja e varreve, pastrimin dhe mirëmbajtjen e tyre, edhe pse në këtë situatë Komuna e Podujevës deri më tani ka ndarë disa shuma të mjeteve buxhetore mirëpo Bashkësia Islame nuk ka pasë ndonjë ofertë nga ndonjë kompani private ose ndonjë nënkontraktor që e ka kryer këtë shërbim që është mirëmbajtja e varrezave, mirëpo qytetarët deri më tani vet i kanë kryer ato shërbime që janë hapja e varrit, mirëmbajtja e varrezave, përjashtimisht ceremonive të varrimit, andaj po besoj se së shpejti tani kemi planin e punës së Ndërmarrjes Publike dhe i kemi edhe planifikimet e që besoj se do të jem iniciues dhe iniciator që do ta ngris këtë temë dhe në koordinim me stafin e Ndërmarrjes Publike besoj se do t'ia dalim dhe do ta fusim pikë të rendit të ditës në Ndërmarrjen Publike dhe besoj se shpejt do ta kemi një marrëveshje me Kryetarin e Komunës së Podujevës.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, edhe unë e kam si pyetje por edhe si sugjerim, në kërkesën e Bashkësisë Islame e kam vërejtur se shuma e kërkuar ka qenë 325 euro mirëpo këtu deri tani nuk u dha ndonjë arsyetim përse ne po diskutojmë dhe po shkojmë drejt votimit për shumën 250 euro, a nuk ka buxhet apo pse, kur jemi në dijeni se të gjitha gjërat janë shtrenjtuar e të cilat veç se janë cekur në kërkesën e Bashkësisë Islame si dhe gjërat tjera për të cilat është dhënë arsyetimi siç është aspekti që tani ekziston morgu dhe shumë tjera nuk u dha arsyetim përse nuk është plotësuar kërkesa e Bashkësisë Islame që ka qenë për 325 euro por që e kanë lënë 250 euro, andaj nëse ka mundësi drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit a mund të na jep përgjigje apo veç shkoj sepse momentalisht nuk është prezent në sallë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, nuk kisha dashtë të kuptohet si polemikë por si sqarim. Kolegu z.Burim Hasani e elaboroj në kuptimin e kapaciteteve në të ardhmen se si do të bëhet kjo në mes Organizatës komunale "Eko-Llapi" dhe shfaq një diçka që Komuna jonë është duke u kujdesuar për mirëmbajtjen e varrezave, krejt për sqarim po e them se në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale, varrezat dhe mirëmbajtja e tyre është obligim i Komunës, ndërsa krejt ajo se në çfarë modalitetesh zgjedh Komuna e kur them Komuna e konsideroj edhe Kuvendin e Komunës edhe



Ekzekutivin e Komunës sepse këto të dyja së bashku përbëjnë Komunën, ato e kanë për obligim të gjejnë modele dhe modure për lehtësim të qytetarëve dhe normalisht nën përkujdesjen siç kish dashtë të jenë varrezat gjegjësisht kalimi nga kjo jetë e të dashurve tanë.

Nuk është Bashkësia Islame obligative, mund të ketë vullnet dhe mund të ketë gjithçka tjetër, por me ligjin mbi funksionimin e pushteteve komunale është obligim ligjor i Komunës për përkujdesjen, mirëmbajtjen gjegjësisht mbarëvajtja lehtësimet dhe gjitha tjerat që ndërlidhen me këtë çështje.

**z.Haki Rudari**, theksoi, natyrisht se kërkesa e kolegut z.Naim Çunaku ishte edhe dje në mbledhjen KPF-së e që mendoj se fillimisht ishte e arsyeshme do të thoja humane dhe njerëzore por mbi të gjitha ne kemi edhe një kërkesë nga Bashkësia Islame drejtuar Kuvendit të komunës përmes Kryetarit të Komunës, do të thotë kjo është kërkesë që neve na është dërguar për kompensimin e shpenzimeve të varrimit.

Ne edhe dje në mbledhjen e KPF-ës debatua dhe e potencua se tani kemi mungesë të faktorit njeri, një pjesë e madhe e njerëzve nëpër fshatra dhe lagje kanë shkuar, mirëpo e dëgjuam edhe arsyetimin e dhënë nga Bashkësia Islame që e lexoj Kryesuesi i Kuvendit ku mundësitë e tyre nuk janë që në këtë moment ta marrin për sipër, prandaj edhe njëherë po e them në emër të Grupit të LVV-së edhe pse e potencoj edhe kolegu z.Xhevdet Maloku do ta përkrahim propozimin që na është dërguar me materialin e mbledhjes. Mbetet që në të ardhmen të shikohen mundësitë dhe modalitetet nëse ka mundësi e që unë edhe njëherë do të thoja është një propozim i arsyeshëm që kolegu z.Naim Çunaku po e bënë ose si një lloj kërkesë që po e bënë.

**z.Burim Hasani**, theksoi, sa i përket përgjegjësisë komunale, vet fakti po tregon se çështja në fjalë është përgjegjësi komunale e Komunës që merret me këto çështje. Pra sa i përket kësaj çështje vet fakti po tregon ngase po që nëse nuk do të ishte përgjegjësi e Komunës atëherë nuk do të ndahej buxhet nga ana e Komunës, por për atë arsye Komuna po ndan buxhet dhe kur ndahet buxheti për një arsye të qëlluar edhe caku duhet të kryhet komplet.

Po ashtu nëse po bën pagesë në Bashkësinë Islame ti parandë tënde je duke e humbur sepse Bashkësia Islame pastaj po tenderon një kompani private, kur të janë mundësitë Komuna e Podujevës nëse po e ofron këtë shërbim ose po e zëm që puna u realizua ku projekti në shumë 325 euro për pjesën e varrimit, nëse e merre bashkësia islame këtë iniciativë le ta merre por sa i përket pjesës së hapjes së varrezave dhe mirëmbajtjes atëherë pagesa të mos shkoj tek kompanitë private por të shkoj tek Ndërmarrja Publike sepse për atë arsye e kemi themeluar. Ti po jap para nga buxheti i Komunës dhe po e dërgon tek kompanitë private e që unë nuk po e shoh shumë të arsyeshme edhe pse në biznes / ARBK e ka si pikë edhe mirëmbajtjen e varrezave, hapësirave gjelbëruese, pastaj hapjen dhe mirëmbajtjen e kanaleve dhe gjitha tjerat, andaj Ndërmarrja Publike besoj se i plotësin këto nevojat sepse ka bager, makineri dhe pajisje tjera andaj nuk po e shoh të arsyeshme të bëhen pagesa pa i kryer shërbimet.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, po mendoj se debati po rrëshqet në një kahe tjetër ngase këtu kemi për diskutim një propozim vendim apo një marrëveshje në mes Kryetarit të Komunës dhe Bashkësisë Islame, ndërsa po diskutohet për Ndërmarrje Publike. Ju (i drejtohet parafolësit z.Burim Hasani) urdhëroni bëje planin në Ndërmarrjen përkatëse Publike, bëjeni marrëveshjen përkatëse, pastaj është mirë që ajo Ndërmarrje të ketë kapacitete qoftë edhe për mirëmbajtjen e varrezave për çka ju pyes a ka, pastaj kërkohet të ketë buxhet shtesë e të tjera çështje, prandaj po e them se jeni duke diskutuar për një temë krejt tjetër nga ajo që kemi në këtë pikë të rendit të ditës.

Mendoj se është mirë të diskutohet edhe kjo çështje, pse jo, madje edhe rekomandimi i kolegut z.Naim Çunaku, por jo të flasim për marrje të vendimit qoftë me 325 euro qoftë me 250 euro, pastaj u fol edhe për buxhetin që u tha se shkon në kompani private e gjëra të ngjashme.

Pra nuk shkon buxheti askund por sot po diskutojmë për këtë propozim vendim që e kemi para vetës, përndryshe ju (i drejtohet sërish parafolësit z.Burim Hasani) mund të bëni marrveshjet në Ndërmarrjen përkatëse Publike dhe bëni dokumentet tjera të nevojshme për shtim të buxhetit, shtim të stafit e të tjera, sillni në Kuvend dhe ne jua përkrahim, mirëpo me kapacitetet aktuale të Ndërmarrjes nuk besoj se do të arrini t'i bëni, kështu që të jemi pak më realistë. Për këtë është dhënë rekomandimi përkatëse nga kolegu z.Naim Çunaku, merruni me këtë çështje si Ndërmarrje Publike dhe përkrahjen tonë do ta keni dhe vetëm vazhdoni, mirëpo të jepen fjalë pa u kryer punët disi unë nuk e dëshiroj fare këtë punë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, unë në emër të grupit të LDK-së edhe në foltore por edhe tani po e përsërisë, nuk jemi kundër këtij vendimi, të gjitha propozimet dhe sugjerimet ishin që ky vendim është i mangët deri sa ne si Komunë nuk arrijmë të gjejmë forma dhe mundësi që ta marrim përsipër edhe rrëmihjen e varrit, dhe sugjeroj ashtu siç ishte sugjerimi edhe i kolegut parafolës z.Bashkim Sylja dhe të tjerë, mirëpo të mos mbetet vetëm sugjerim sepse po të njëjtën temë dhe po të njëjtin propozim e kemi pasë edhe para dy viteve kur kemi diskutuar për këtë çështje, prandaj të mos mbetet vetëm si propozim por nëse vërtetë jemi të interesuar ta lehtësojmë jetën e qytetarëve dhe në momentet më të vështira të tyre të jemi krah, duhet të gjenden module e moduse siç të dëshironi të parashihet edhe kjo çështje që po bisedojmë, përndryshe edhe në këtë formë siç është sjellë ne nuk jemi kundër.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, unë po e vërej se debati i të gjithëve është për një punë më të mirë që të bëhet, nuk ka as dallime politike as partiake kështu që qëllimi është që sa më mirë të kryhet shërbimi ndaj qytetarëve, prandaj ftoj drejtorin e Drejtorisë përkatëse të jap sqarime dhe përgjigje shtesë sa i përket këtij propozim vendimi.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSh dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM, theksoi, dëgjuam diskutimet për një temë e cila ashtu siç u cek është temë e ndjeshme dhe unë po e potencoj atë se çfarë është marrë dhe çfarë është propozuar nga Komuna e Podujevës respektivisht nga Kryetari i Komunës sa i përket subvencionimit për çështjen në fjalë, pra po diskutojmë për subvencionim sepse nganjëherë po ngatërrohen temat dhe po e vërej se situata po del jashtë temës për çka pajtohëm edhe me z.Bashkim Sylja i cili e ceku se po dalim jashtë temës me diskutime.

Ne po diskutojmë për një subvencionim Bashkësisë Islame për shërbimet e varrimit, do të thotë, Kryetari i Komunës e përgatit një propozim vendim, Kuvendi e miraton atë, dhe Kryetari i Komunës lidh një marrëveshje për subvencionim për shërbimet e varrimit.

Sa i përket këtij subvencionimi ju e dini që në vazhdimësi është përcjellë në vitet e fundit me mundësi edhe të rritjes së shumës së subvencionimit ku tani veç e kemi rritur shumën në 250€ për një person gjë që i tejkaluar edhe limitet buxhetore mirëpo bazuar në shërbimet që bëhen dhe bazuar në çmime aktuale të tregut jemi obliguar domosdoshmërisht ta rritim çmimin që e ceka.

Sa i përket hapjes së varreve për të cilën u fol shumë, tani ne jemi në një situatë kur paraprakisht kemi biseduar edhe me krerët e Bashkësisë Islame edhe në formë verbale para se ata të na drejtohen me shkrim, në mënyrë që të kërkojmë një modalitet se në çfarë forme mund të hapim varret, pra që ta subvencionojmë edhe hapjen e varreve dhe tani ishte ai keqkuptimi ku u ndërlikohet situata me Ndërmarrjen Publike por ta keni të qartë se Komuna nuk bënë marrëveshje me Ndërmarrjen Publike për t'i hapë varret i nderuar zotëri aksionar në këtë rast (i drejtohet z.Burim Hasanit), por Komuna jep subvencionin ndërsa marrëveshjen me Ndërmarrjen Publike e bënë Bashkësia Islame, pra nuk mund edhe të thuash po i'a transferoj paratë për hapje të varrit edhe po bëjë kontratë me Ndërmarrjen Publike Lokale "Eko-Llapi" për të hapë varrin, do të thotë duhet ta kemi të qartë që këto janë gjëra të ndara, Komuna nuk hap varre por Komuna jep subvencionim.

Po që se është mundësia dhe nëse do të pranohej prej Bashkësisë Islame të cilët po të thonin se po ne jemi të gatshëm të marrim përsipër edhe hapjen e varreve do të ishim të gatshëm të paguajmë edhe këtë shërbim i cili u përmend dhe që ka dalë edhe si kërkesë nga z.Naim Çunaku, do të thotë duhet ata Bashkësia Islame fillimisht ta pranojnë si detyrë e pastaj ne t'i subvencionojmë për hapjen e varreve, ndërsa ne të bëjmë marrëveshje me një Ndërmarrje Publike ose private apo çfarë do qoftë, nuk është e nevojshme përderisa ne i subvencionojmë Bashkësinë Islame-Podujevë.

Pra edhe njëherë po e them se duhet të kemi të qartë, përgjegjësitë që na takojnë neve si Komunë e vetmja përgjegjësi është subvencionimi dhe sipas propozimi vendimit kjo është me marrëveshje, nuk është që jemi të obliguar dhe duhet ta kuptojmë edhe këtë gjë, subvencionimi nuk nënkupton obligim por nënkupton mbështetje për Bashkësinë Islame me aq kapacitete sa ka Komuna dhe ne këtë e kemi bërë në vazhdimësi dhe po vazhdojmë ta bëjmë, kurse tash a lidhë kontratë a lidh marrëveshje Bashkësia Islame me Ndërmarrjen Publike Lokale "Eko-Llapi" apo jo është krejt çështje tjetër, ata mund të bëjnë marrëveshje edhe me ndonjë ndërmarrje private e cila mund t'i oferton me çmim më të lirë dhe mund të lidh marrëveshje dhe nuk merret me Ndërmarrjen Publike fare, pra e ka atë të drejtë dhe atë mundësi, kurse a është e drejtë e jona që të mundohemi ta kalojmë këtë tek NPL "Eko-Llapi" nëse mendohet se ka përfitime edhe kjo Ndërmarrje Publike është e drejtë të insistohet dhe të mundohemi mirëpo e drejta finale i takon atyre.

Gjithashtu duhet ta kemi parasysh se te NPL "Eko-Llapi" duhet ta ndërrojmë edhe aktivitetin e veprimit të punëve që i bënë kjo Ndërmarrje e që kjo nuk bëhet në Komunë por bëhet në Ministri, pra duhet të jetë e shkruar si aktivitet i punëve që i kryen Ndërmarrja që është edhe një problem tjetër shtesë përveç atyre tjerave që u përmenden. Ndryshimi i aktiviteteve që i Ndërmarrja në fjalë ku janë të shkruara një varg aktivitetesh ato në parim fillimisht duhet të ndërrohen dhe pastaj të vazhdohet me punët që mund t'i bëjë ajo.

Ne jemi të gatshëm dhe kemi qenë gjithëherë ta ndihmojmë dhe subvencionojmë në formën sa më të mirë Bashkësinë Islame, mirëpo kur Bashkësia Islame të jep përveç verbale një përgjigjeje edhe në formë të shkruar duke potencuar se nuk është e gatshme ta marrë atë shërbim dhe duke dhënë arsyet e veta përse nuk mundet të cilat u lexuan në fillim prej Kryesuesit të Kuvendit, arsye të cilat nuk janë të pakta por janë bukur të shumta ku e para është ajo që ne thuajse e kemi dendësinë e varrezave dhe qysh mundet Bashkësia Islame apo cilado kompani që e merr kontratën për t'i hapë varret të shkoj deri tek një varrë i caktuar dhe të bëjë hapjen e varrit, të shkelë / kalon në ose mbi varre tjera ekzistuese, nuk mundet sepse nuk e lejojnë familjarët tjerë e që as unë nuk do ta lejoja të shkelet/kalohet mbi varret e familjarëve tanë për të shkuar në hapjen e një varri tjetër, dhe kjo është njëra prej arsyeve që ata e kanë cekë dhe që e kemi diskutuar bashkërisht me Bashkësinë Islame. Arsye tjetër ishte edhe rastet që mund të ndodhin në të njëjtën kohë në gjithë territorin e Komunës së Podujevës dhe tani po supozojmë që NPL "Eko-Llapi" do të merret me këtë çështje dhe është një rast i hapjes së varrit në fshatin Pakashticë kurse tjetri është në fshatin Orllan si dhe tjetri është ta zëmë në fshatin Lupç e që ndoshta mund të jenë 4-5 raste brenda ditës, a do t'i lëmë ne tani qytetarët pa hapjen e varrit për familjarin e tyre apo do të detyrohen sërish ata që hapjen e varrit ta bëjnë vet sepse kufomën mbi tokë nuk mund ta lëmë askush, mirëpo a mund t'i ofrojmë shërbim siç kërkohet dhe siç bëhet pagesa është çështje për t'u diskutuar e cila madje është diskutuar edhe me Bashkësinë Islame dhe diskutime tjera të gjata si temë.

Edhe njëherë po e them që nëse Bashkësia Islame është e gatshme ta merre dhe pranoj këtë shërbim për hapjen e varreve edhe ne jemi të gatshëm t'i mbështesim duke rritur subvencionimin me aq mundësi buxhetore sa kemi edhe për shërbimin e hapjes së varreve.

Pra u mundova të sqaroj paksa edhe pse ndoshta nuk mund të kem qenë krejt i qartë ashtu siç kërkohet, por për çka do që mund të ketë ndonjë paqartësi ose pakënaqësi sërish mund të diskutojmë në vazhdim.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, më bëri të marrë sërish fjalën ajo që kinse ne gjithsecili që po marrim fjalën po ekzagjerojmë, po hyjmë në territor tjetër dhe gjëra të tjera, e që pastaj po gjejmë vërejtje pastaj edhe në diskutimet tona të mëparshme dhe edhe vet po dalim në një territor tjetër. Unë jam përfaqësues i qytetarëve në Kuvendin e Komunës së Podujevës si anëtar i tij i votuar dhe me obligim t'i mbrojtë dhe t'i përfaqësoj interesat e qytetarëve të Komunës së Podujevës. Unë nuk jam përfaqësues i Bashkësisë Islame dhe unë në asnjë formë nuk jam këtu të mbrojtë arsyeshmërinë apo atë formës që e kanë zgjedhur sikur ne të ofrojmë një subvencionim sikur të jetë ndonjë "tryezë Suedeze" duke deklaruar se këtë mund ta bëjë, atë s'mund ta bëjë.

E potencova qysh në fillim, nuk jam dhe nuk mund ndikoj Bashkësisë Islame se fundja ne jemi të drejtë, ne e kemi zgjedhë si partnerë që të subvencionojmë përmes Bashkësisë Islame lehtësimin e jetës së qytetarëve gjegjësisht shpenzimet e varrimit, por partnerët Komuna i zgjedh, ashtu siç e përmendi drejtori parafolës që nuk është me automatizëm që "Eko-Llapi" të jetë e përzgjedhur dhe qysh është Komuna jonë për të bërë një shërbim të caktuar ne e dimë, jetojmë në një ekonomi të tregut dhe qysh duhet të veprohet me para publike, e dim atë gjë që nëse veç është NPL "Eko-Llapi" më e favorshme mund ta merre një punë të Komunës, nëse nuk është edhe pse është e Komunës nuk mund ta merr, atë duhet ta kemi të qartë çdo njëri sepse në ekonomi të tregut jemi.

Ajo që dua të dal dhe që nuk pajtoj me drejtorin parafolës i cili e tha që Komuna nuk hap varre, kurse unë e thash që Komuna e ka obligim mirëmbajtjen e varrezave, por nëse Komuna nuk hap varre atëherë e kam një pyetje për drejtorin parafolës të DSHPMSH, a qan dërrasa Komuna, pra as dërrasa nuk qan, pastaj as punëtori të tekstitit nuk ka, mirëpo kjo ishte arsytimi, por nëse për mua si përfaqësues i qytetarëve, nëse edhe ne të gjithë po vijmë në konkludim se puna më e vështirë në atë ditë si ditë të rënduar të një familje është rrëmihja e varrit, dhe tani nuk po bëjmë përpjekje të gjejmë modelin qysh ne ta bëjmë këtë zgjidhje, por po themi është e vështirë dhe meqë është e vështirë atë nuk e marrë përsipër as ai, as ky as askush por leje qysh është, këtu është poenta, prandaj unë e thash që të mundohemi të gjejmë rrugë qysh dhe çka dimë që t'i dalim në ndihmë asaj familje de atyre njerëzve që ne ta marrim si obligim ngase po themi se po subvencionojmë varrimin, pra këtu ishte poenta, përndryshe unë nuk jam Ekzekutiv dhe të dal në foltore, modelet më të favorshme për Komunën i ka për detyrë Ekzekutivi i Komunës, ndërsa ne marrim vendime.

Dëgjova edhe një diçka që u tha se është propozuar një vendim, çka që është propozuar një vendim, në Kuvend gjithëherë propozime të vendimeve vijnë por nëse ai propozim vendim është i pafavorshëm për qytetarin atëherë përse jemi ne këtu, përndryshe ne jemi këtu edhe për të modifikuar, për ta ndryshuar dhe për të gjete m të favorshmen që i konvenon qytetarëve, prandaj për atë është Kuvendi i Komunës, ne marrim vendime, nuk marrin ata me një shkresë vendim.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSH dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të DPUMM, theksoi, i nderuar Naim Çunaku, nuk e di çfarë keni pasë ne mendje kur unë e potencova që Komuna nuk hap varre dhe është e njëjta gjë sikurse kur je potencuat që Komuna nuk ka fabrik të përpunimit të drurit e as nuk ka fabrikë të tekstitit andaj për t'i përmbledhë gjitha këto çështje unë e potencova një gjë e cila është shumë me rëndësi, thash Komuna nuk subvencionon Bashkësinë Islame e cila i kryen këto veprime ashtu siç është rasti edhe me hapjen e varreve....

**z.Naim Çunaku**, duke kërkuar falje për ndërhyrjen, theksoi, Komuna e ka zgjedh partnerë Bashkësinë Islame, Komuna mund ta ndërrohet partnerin, kurse ne nuk mund të ndërhyjmë tek Bashkësia islame sa i përket riteve fetare dhe shërbimeve tjera përkatëse.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSh dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të DPUMM, vazhdoi, pra po e vazhdoi aty ku mbeta, është i njëjti rast sikurse me hapjen e varreve sikurse edhe me gjitha shërbimet tjera Komuna subvencionon, pra këtë e thash shumë qartë se nëse Bashkësia Islame bënë kërkesë edhe për këtë çështje e ceka se do ta diskutojmë, e kemi diskutuar dhe do të shikojmë mundësitë buxhetore dhe do të ndajmë buxhetin e nevojshëm për t'i mbështetur, mirëpo modalitete se qysh të bëhet me Ndërmarrjen Publike, kurse me ndërmarrje private sigurisht jeni në dijeni se fillimisht duhet të ndajmë buxhet në vijë të veçantë buxhetore, të nderojmë dhe të lidhim kontratë me operatorë privat e që tregu i lirë e përcakton atë pastaj dhe pastaj prap se prap është e pa ekzekutueshme në bazë të asaj edhe çfarë e potencon edhe Bashkësia Islame për pjesën e saj por edhe në bazë të terrenit që është jo i studiuar mirë e që jemi në dijeni të gjithë se është vështirë i ekzekutueshëm, por duhet ta mbështesim dhe subvencionojmë me aq mundësi dhe ashtu siç kërkohet subvencionimi.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, qëllimi i të gjithëve është që shërbimi të kryhet sa më mirë. Bashkësia Islame ka bërë kërkesë për ato shërbime që mund t'i kryej, mirëpo nuk do të thotë që edhe duhet të pajtohemi me gjitha ato kërkesa që i ka bërë, ne mund të shtrojmë edhe ndonjë kërkesë dhe për atë është Kuvendi i Komunës që të debatoj, përndryshe nëse ne si Kuvend jemi që vetëm të bëjmë "aminin" ashtu siç u potencua që është sjellë në Kuvend dhe vetëm votojeni, mirëpo unë nuk shohë të keqe asgjë përse këtu debatohet aq shumë për një çështje shumë të ndjeshme, unë mendoj se është shumë e ndjeshme.

Në fakt Bashkësia Islame ka sjellë një kërkesë me disa pika për ato shërbime, mirëpo unë mendoj se asgjë të keqe nuk po bëjmë ne që po kërkojmë një shërbim më shumë, asgjë tjetër nuk kemi.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, Kuvendi i Komunës e përcakton buxhetin e Komunës, ne po ta kishim në planifikim me kohë subvencionimin e shërbimeve të varrimit dhe e kemi kodin buxhetor, ne do të subvencionojmë, atëherë ne e zgjedhim partnerin përmes kujt na kryhet ajo punë më lirë e më mirë, në këtë rast unë pyes a kemi përzgjedh, jo, por vetëm është një kërkesë e dikujt dhe e kemi mbështetur atë kërkesë.

Përndryshe këto janë fjalë të ndjeshme që mund të keqpërdoren, ky në këtë formë ai në atë formë, mirëpo duhet të dallojmë obligimet jashtë ritit fetar me ritin fetar, Bashkësia Islame është për ritin fetar sepse fundja për atë e merre edhe anëtarësinë dhe për atë funksionon, mirëpo po më shkon "buza në gaz" kur dëgjova në arsyetim që është thënë se është sepse me i'a hap të afërmit varrin.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, besoj se diskutimet përfunduan për këtë pikë dhe nuk kemi çfarë të diskutojmë më shumë, andaj e hedh në votim propozim vendimin për subvencionimin e shpenzimeve të varrimit për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 26 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

### 3. Draft Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës, për vitin 2025

**Kryesuesi i Kuvendit**, paraqiti draft Planin e Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2025, theksoi, në hartimin e Draft Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2025 mund të them se kanë marrë pjesë shumica e anëtarëve të Kuvendit të komunës të cilët kanë dhënë propozimet dhe sugjerimet e tyre dhe në fund kemi bërë një Plan të Punës së kuvendit për vitin e ardhshëm.

Këtu kemi prezentë edhe drejtor të Drejtorive të Komunës por edhe anëtar/e të Kuvendit të cilët ndoshta nuk kanë qenë prezent në përgatitjen e këtij drafti, andaj gjatë debatit mund të jepen propozime dhe sugjerime të ndryshe në qoftë se kanë diçka lidhur me Planin e Punës së Kuvendit, kështu që e hapi diskutimin për këtë draft Plan sipas kësaj pike të rendit të ditës.

**z.Haki Rudari**, theksoi, natyrisht se Planin e Punës së Kuvendit është një prej dokumenteve më të rëndësishme nëpër të cilat sigurisht që kalon Kuvendi i Komunës apo në përgjithësi mbarëvajtja e seancave brenda një viti. Natyrisht që plani i punës edhe unë e propozoj një plan të punës që është serioz, që është i përgatitur mirë, që është gjithëpërfshirës dhe mbi të gjitha që bazohet Rregullore. Në materialin që na është sjellë neve këshilltarëve të Kuvendit, po citoj, për mbarëvajtjen e zbatimit të aktiviteteve sipas dinamikës së përcaktuar me këtë Plan do të përkujdesen Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit, pra kjo i bie që për mbarëvajtjen e seancave duhet realisht të merret shumë seriozisht këta të cilët na e kanë sjellë këtë material, këtu nuk po shkruan që shefat e Grupeve janë përgjegjës.

Çështja tjetër, po citoj, realizmi i Planit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës i cili duhet që sa më shumë të jetë e mundur, unë propozoj që kjo të hiqet sepse kjo me mundësi nuk shkon, ktu duhet të jetë ... e kanë të obliguar. Unë nuk e kam me mundësi që të shkoj nesër të mbaj orët në shkollë, por e kam obligim të mbaj orët në shkollë, prandaj këtu mendoj se duhet të punohet me obligim e jo me dëshira e mundësi, ka apo nuk ka dëshirë apo mundësi sepse mundësi/dëshirat janë jashtë Kuvendit të Komunës, janë institucionet tjera, janë restorantet, sheshet e të tjera e të tjera.

Prandaj për të përfunduar me këtë sepse sigurisht se do të kenë propozime edhe të tjerët, unë Haki Rudari si shef i Grupit po foli, jam për një Plan serioz, gjithëpërfshirës, të përgatitur dhe që respektohet.

Unë e kam thënë edhe sa kam qenë në opozitë dhe po e them edhe tani, urdhëroni ndryshojeni Rregulloren, fare nuk e kam problem kur ndryshohet Rregullorja, kurse në Rregullore shkruhet që duhet të caktohet edhe data dhe më së shumti thuhet ka mundësi 7 ditë të shtyhet seanca, krejt në rregull është, ne si Kuvend duhet ta caktojmë datën e 11 seancave dhe ajo datë mund të ndryshoj më së shumti 7 ditë pune.

**Kryesuesi i Kuvendit**, potencon se nuk do t'ju drejtohem me Grupe sepse këtu jemi anëtar/e të barabartë të Kuvendit të Komunës, kështu që urdhëroni.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, unë me këtë draft Plan nuk jam i pakënaqur qysh është bërë / hartuar, por qysh nuk po realizohet. Tani nëse marrim për vitin që po e lëm pas nuk e di a është realizuar 20% e pikave të cilat veç i kemi futur në Plan të Punës para rreth 1 viti, apo jo.

Do të thotë është obligim i Kryetarit të Komunës që të vije para Kuvendit të Komunës të raportoj 2 herë në vit e ai nuk vie. Pastaj Drejtoritë e Komunës, jo të gjitha, përjashtimisht 2-3 Drejtori, janë që kanë raportuar apo që kanë paraqitur informata, të tjerat është viti i katërt që po hyjmë dhe asnjëherë asnjë informatë nuk e kanë dhënë në Kuvendin e Komunës, as Drejtoria e Urbanizmit, as e Kulturës Rinisë dhe Sporti, as e Shërbimeve Publike, e të tjerat.

Tani nëse vetëm dëshirojnë ta votojnë këtë Plan dhe të mos e realizojnë këtë Plan, unë prej teje i nderuar Kryesuesi i Kuvendit kërkoj që nëse ne po e votojmë këtë Plan të Punës së Kuvendit, t'i

mundesh që rendin e ditës tek Drejtorët e Drejtorive por edhe te Kryetari i Komunës kur është koha dhe të na e sjellni neve materialin, këta të mos vijnë pastaj të japin informatë, dalim ne disa aty në foltore dhe flasim. Pra ti i nderuar Kryesues e dërgon nëpër Drejtori, materialin e ke dhe ashtu siç na e dërgon neve materialin ashtu e dërgon edhe tek drejtorët e Drejtorive, dhe ata vijnë për informatë, nëse nuk vijnë ne pastaj u japim informatat atyre, por jo të tejkalohen dhe të mos sjellën si pika të rendit të ditës asnjëherë, ti Kryesues sjelle si pikë të rendit të ditës, e ai drejtor të mos raportoj e as të jep informatë asnjëherë.

**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, sa i përket Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2025, unë do të sugjeroja që të ndryshoj renditja për pikën e propozuar në muajin nëntor të vitit 2025 që është; Informatë mbi sigurinë në Komunën e Podujevës, informatë e cila do të jepet nga Policia e Kosovës, pra unë propozoj që kjo të kalon në janar 2025, edhe pse prap e vonuar.

Këtë propozim e paraqes për këto arsye sepse Informata mbi sigurinë kemi nevojë të kemi më shpesh, po ashtu kemi parë disa dukuri të cilat kanë ndodh në Komunën e Podujevës së fundmi dhe po ndodhin siç është arrestimi nga ana e Serbisë i dy personave qytetarë të Komunës së Podujevës, si dhe po ashtu një tendencë nga disa persona për të prishur qetësin dhe harmoninë fetare në Komunën e Podujevës e që besoj se kanë ndodh edhe disa arrestime, kështu që besoj se do të ishte mirë të kemi një Informatë nga ana e Policisë sa më shpejt, kështu që propozoj që kjo të jetë në janar të vitit 2025.

*Për rreth 1 minutë, Kryesuesi i Kuvendit del nga salla dhe atë për arsye personale.*

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, të gjithë jemi në dijeni se ke nevojë të lëvizësh, mirëpo praktikoje sepse nuk bëhet asgjë (nami) të thërrasësh ndonjërin prej anëtarëve të Kuvendit ashtu siç e përcakton ligji dhe ti mund të vonohesh sado që dëshiron dhe jemi në rregull, por nuk është hijshme ajo situatë që na ndodhi. Si do që të jetë këtë e potencova që ta marrësh si sugjerim, asgjë tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit**, duke i'u përgjigjur parafolësit theksoi, unë si Kryesues i Kuvendit nuk kam zëvendës.

**z.Naim Çunaku**, vazhdoi, nuk është në pyetje zëvendës Kryesuesi i Kuvendit sepse nuk ke të drejtë, mirëpo e ka përcaktuar ligji atë formë, pra me ligj është përcaktuar se kush e udhëheqë mbledhjen në mungesë të Kryesuesit. Nuk është me rëndësi ajo dhe nuk është asgjë thujse por mu duk jo njerëzore të të thërret dikush me gisht nga jashtë dhe ti të dalësh menjëherë ashtu.

Sa i përket Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025, më bëri të flas shefi i Grupit të këshilltarëve të LVV-së z.Haki Rudari i cili e lexoi Rregulloren, diçka që është e dijshme për neve, por e keqja e madhe është që një diçka që e dimë me vetëdije jemi duke mos i'u përmbajtur dhe ne në bazë të statusit që e kemi, qysh na përcakton Statuti i Komunës dhe aktet tjera normative, vërejtjen duhet ta gjejmë tek ne.

Gjithashtu e përmendi disa herë që duhet ta kemi një Plan serioz, e që unë e them se vërtetë që çdo Plan duhet të jetë serioz mirëpo të flasësh për Planin e Punës së Kuvendit si organi më i lartë i Komunës tregon vet ajo për seriozitetin që do të duhej ta kishte.

Pastaj u potencua edhe mos përmbajtja e Planit të Punës, vërtetë për t'u gjykuar, nuk kemi arrite në atë shkallë që Ekzekutivi i Komunës ta kuptoj që raportimet para Kuvendit janë obligime ligjore dhe fundja një kritikë, një shkelje, një e gjetur, një lëvdatë do t'i bënte mirë edhe Ekzekutivit të Komunës por edhe do ta kryente punën e vet sepse fundja janë llogaridhënës ara Kuvendit.

Për fund unë e di që edhe ky Plan do t akëte rrugës fatin e Planeve tjera, por fundja ne si Kuvend e kemi obligim ligjor ta kemi Planin e Punës dhe atë po e bëjmë, çdo kush një ditë do kishte dashtë

të jepte llogari për sjelljen e tij gjegjësisht llogaridhënien apo arsyen për mos dhënien llogari para Kuvendit.

Krejt në fund e mbështes propozimin e parafolësit z.Xhevdet Maloku që në një të ardhme të afërt kur mund të jetë mundësisht më së afërmi ta kemi një Informatë mbi gjendjen e sigurisë në Komunën tonë. Ne jemi në dijeni se e kemi një Komision të ndërtuar prej Kuvendit të Komunës dhe do të duhej të jemi për afër të njoftuar me gjendjen të cilën e kemi në Komunën tonë, përndryshe uroj që ky Plan të realizohet në mënyrë që të mos jetë vetëm shkronja ashtu siç kanë mbetur plante tjera.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ne për Plan të Punës së Kuvendit, po sa të miratohet në Kuvend dhe të hyn në fuqi, çdo Drejtorie jua dërgojmë qoftë përmes e-mailit qoftë në formë fizike, kështu që të gjitha Drejtoritë e Komunës janë të informuara ndërsa a i përmbahen apo jo ne kemi edhe shembuj të mirë ku drejtorët përkatës të Drejtorive vijmë me nga dy informata në vit për Kuvendin e Komunës dhe e prezantojnë punën e tyre ashtu siç është bërë e që ndoshta shumë herë marrin edhe kritika por e realizojnë atë që e kemi paraparë në Plan të Punës, kështu që edhe drejtorët tjerë të Drejtorive i kanë të caktuara ditët, muajt, mbledhjet dhe mund t'i sjellin pikat, ne nuk jemi ata që mund t'i detyrojmë t'i sjellin por atë që ne obligohemi ne edhe e bëjmë duke i njoftuar ndërsa është detyrë e tyre që t'i paraqesin apo jo në mbledhjet e Kuvendit.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, harrova të përmend edhe një gjë, i nderuar Kryesues i Kuvendit, kolegu z.Ekrem Rrahmani të bëri një propozim shumë të sakt, ti si Kryesues i Kuvendit dhe ne si anëtar/e të Kuvendit jemi të obliguar t'i përmbahemi Planit të Punës ndërsa a vjen apo nuk vjen drejtori i Drejtorisë përkatëse të raportoj nuk është problem i yti Kryesues, mirëpo problem i yti Kryesues është që ta përfshish në rend të ditës ashti siç përcaktohet në Plan të Punës, kurse ai zotëriu apo ajo zonja e që në fakt më pak po kemi probleme me zonjat për çka edhe dje në KPF i falënderova që po janë më të përkushtuara në raportim, të mos vijmë por qytetari ta shoh, Kryetari i Komunës ta shoh dhe ne si anëtar/e të Kuvendit ta shohim e që në fund edhe ta ndajmë atë që është i përgjegjshëm, atë që dëshiron ta përmbush anën ligjore dhe atë që nuk dëshiron, por jo tani të na tërheqë neve pse ai nuk dëshiron të jap informatë, e ne të mos e kemi pikë të rendit të ditës, pse të na involvon neve në një diçka që ai është shkelës, jo ne.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ka ndonjë të lajmëruar për të marrë fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim draft Planin e punës së Kuvendit për vitin 2025 sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes si dhe propozimit të z.Xhevdet Maloku që pika Informatë mbi sigurinë në Komunën e Podujevës e planifikuar në muajin nëntor të zhvendoset në muajin janar 2025.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 20 anëtarët sa ishin prezent në sallë, me 19 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë e Përmbajtur, miratohet Draft Planin e Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2025, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe ndryshim plotësimin e propozuar nga z.Xhevdet Maloku, përkatësisht që pika Informatë mbi sigurinë në Komunën e Podujevës (nga Policia-Podujevë) e paraparë në muajin nëntor 2025 të zhvendoset në muajin janar 2025.*



#### **4. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025**

**znj.Saranda Stublla**, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, sot në këtë mbledhje si pikë të rendit të ditës kemi miratimin e Listës së veçantë të pronave për vitin 2025.

Një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi paraqitur si material shtesë edhe disa lokale të cilat janë në parcelën 536 në Zonën Kadastrale në Podujevë, material të cilin e adresove te Zyra ligjore për t'jua shpërndarë juve e që besoj se e kanë kryer punën e tyre Zyra ligjore, andaj pres mbështetjen e juaj për këtë pikë të rendit të ditës.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, në emër të këshilltarëve të LVV-së e përkrahim propozim vendimin për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme për vitin 2025.

**z.Valon Demolli**, theksoi, fillimisht sa i përket Listës së këtyre pronave ne Grupi i LDK-së nuk do të marrim pjesë në këtë votim për shkak se këto prona siç e dim ky Kuvend në vitin 2017 e ka dhënë në shfrytëzim parcelën Klubit Futbollistik KF Llapit, andaj me këto lojëra politike të Kryetarit të Komunës për interesa puro personale e për t'i shpërblyer disa "jarana" të tij. Këto prona janë dhënë në shfrytëzim dhe i takojnë KF Llapit, andaj nuk e di përse është dashtë që këto prona të sjellën sërish për dhënie në shfrytëzim, prona të cilat janë brenda parcelës për të cilën e dim që është pjesë e KF Llapit.

Fillimisht tek një lokal aty drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit ka shkuar dhe i ka vë shiritat, pastaj ka shkuar sërish vet dhe i ka heq shiritat, andaj nuk e di përse duhet të jenë këto sepse këto prona i takojnë KF Llapit, kjo është parcelë e cila është dhënë në vitin 2017 dhe jemi krenar që Familja Batatina po na përfaqëson në mënyrën më të mirë të mundshme, kështu që nuk po shoh arsye përse duhet të vijnë këto prona për dhënie në shfrytëzim kur se janë dhënë në vitin 2017.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, tani kur kemi paravetës në rend të punës pikën që është Lista e veçantë e pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, po e përmbushim një obligim ligjor që është e përcaktuar që të gjitha pronat që ne mendojmë si Kuvend t'i japim në shfrytëzim duhet që ta kapërcejnë këtë procedurë para fillimit të vitit tjetër kalendarik ta kemi një vendim që është interes i Komunës për të dhënë në shfrytëzim.

Kur bisedojmë për prona komunale po e them nj diçka që e potencova edhe dje në KPF, një prej obligimeve parësore për një Komunë është ruajtja dhe avancimi i pronës komunale në kushtet dhe standardet e tregut të ruaj vlerën e tyre si arsye e parë, ndërsa si arsye e dytë mendoj që një aset i Komunës me gjithë këto prona duhet të jepet në shfrytëzim për rritje ekonomike, për krijimin e mundësisë së një afarizmi më të mirë dhe me këto dyja e përcaktojmë edhe rritjen e mirëqenies sociale, si dhe krejt në fund që është arsyeja pse Komuna i jep në shfrytëzim është për t'i krijuar vetës të hyra vetanake.

Jemi në dijeni se një pjesë e mirë e pronave tona/komunale, për një kohë të gjatë po thuajse nga pas lufta e këndej shumë prej tyre shfrytëzohen pa e ditur kush i shfrytëzon, në çfarë gjendje janë, ku janë, dhe unë mendoj që në një të ardhme të afërt dikush duhet të merret seriozisht me pronat komunale në kuptimin e mirëmbajtjes së tyre dhe kuptimin e dhënie në shfrytëzim për rritje ekonomike dhe mirëqenie. Ne asnjëherë nuk kemi pas një raport e që është dashtë ta kemi për gjendjen e pronave komunale dhe këtë e them sepse në vitin e kaluar përafërsisht një Listë sikur se kjo e kemi aprovuar përafërsisht në të njëjtën kohë në këtë Kuvend dhe a kemi marrë mundin të shohim se sa prej atyre pronave i kemi dhënë në funksionin dhe qëllimin të cilin e kemi paraparë, kurse pjesa dërmuese e tyre kanë mbet o për fajin ku di unë, komisionit, OJQ-ve, o mos interesit të qytetarëve, dhe pak nga mundësitë që i kemi pasë qoftë për krijimin e të hyrave vetanake qoftë për afrim të lehtësimit të operatorëve ekonomik i kemi lën në atë qëllimin kryesor të tyre që jepen në shfrytëzim, kanë mbete një aset i fjetur i Komunës që unë mendoj se ky aset duhet t'i përkushtohet

më shumë kohë, më shumë debat dhe të punohet më shumë që pronat tona komunale të mos mbeten aset i fjetur por të dalin në funksion të ekonomisë së tregut dhe të krijojnë të hyra edhe për Komunën edhe për mirëqenien sociale.

Një ditë më parë në mbledhjen e KPF-së tërthorazi e patëm që një pjesë e këtyre pronave që është dashtë t'i kaloj procedurat përmes Kuvendit de përmes Komunës, mu duk sot banale dhe aq shqetësuese që edhe komisionet që ne i kemi ngritur në këtë Kuvend, për mos punën e tyre kanë dështuar për dhënien në shfrytëzim, andaj nuk do të doja dhe uroj të mos përsëriten në vitin e ardhshëm këto defekte por t'i përkushtohemi më tepër dhe prona ta luan rolin e atyre që i përmenda më shumë se njëherë, në funksion të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të punës dhe krijimit të mirëqenies sociale së qytetarëve si dhe ruajtjes si obligim ligjor që kemi.

**z.Shuajb Blakçori**-Drejtorja e Inspeksionit DI dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Administratës DA, theksoi, dëshiroj të replikoj asamblistit zotëri Valon Demolli i cili në një mënyrë banale fol përpara qytetarëve të Komunës së Podujevës kur thotë që Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit ka vendos shiritat dhe drejtori i drejtorisë së Inspeksionit ka heq shiritat, kjo nuk është aspak e vërtetë sepse inspektorët tanë të ndërtimitarisë kanë dalë në vend ngjarje atje dhe ata nuk e kanë asnjë pëlqim të vetëm për shfrytëzim të atyre lokaleve, kjo është arsyeja, andaj nuk është në rregull të dilet këtu në foltore dhe të thuhet që drejtori ka vendos shirita dhe drejtori ka heq shirita.

**z.Valon Demolli**, theksoi, me gjithë respektin për drejtorin parafolës mirëpo po e shoh që nuk është në temë hiq ngase nuk e pata fjalën për këtë drejtor dhe madje ky nuk është duke e ditë hiq për cilin lokal jam duke fol unë, fjala ishte për lokalin ku është kafiteri që drejtori ka shkuar ka vë shirita në vitin e kaluar dhe pastaj ka shkuar po vet ai edhe i ka heq shiritat, pra drejtor nuk është tema tek ky ndërtimi i tashëm por është i vitit të kaluar, prandaj po më vie keq.

**znj.Saranda Stublla**, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, sa i parket parcelës në fjalë unë e potencova që janë të përfshira në Listë të veçantë lokalet por jo edhe parcela.

Sa i përket assembleistit parafolës i cili e potencoj se në vitin 2017 i është dhënë në shfrytëzim KF Llapit, ne kemi hulumtuar në arkivat e Komunës për ta gjet atë vendim që i është dhënë por ne nuk e kemi gjet, nëse ju e keni luteni ta sjellëni.

**z.Ekrem Rrahmani**, i drejtohet drejtoreshës parafolëse, theksoi, ndoshta nuk është gjet sepse janë kallë serverët këtu, duhet me ditë përse nuk po e gjen, qysh është marrë vendimi dhe nuk po e gjejnë këta që është marrë vendimi. Janë kallë serverët këtu deh askush nuk ka treguar sa dokumente mungojnë dhe çka bëhet, përndryshe ne nuk e kemi obligim t'i ruajmë vendimet.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, vendimet e Kuvendit ruhen edhe në kopje fizike në Zyrën ligjore, kështu që nuk ka çka diskutojmë për këtë.

**znj.Donjetë Sheqiri**, pyet drejtoreshën e DPKGJ, a është publikuar Lista e përgjithshme e pronave komunale.

**znj.Saranda Stublla**, drejtoresh e DPKGJ, përgjigje parafolëses, theksoi, po është publikuar në ueb faqe të Komunës Lista për të cilën folët.

**znj.Donjetë Sheqiri**, sërish i drejtohet drejtoreshës së DPKGJ, theksoi, pyetja ime ishte se a është publikuar edhe gjendja e përgjithshme e pronave sepse me ligj specifikohet që duhet të publikohet edhe gjendja e pronave komunale, do të thotë të gjitha pronat dhe gjendja e tyre, kush i ka në shfrytëzim dhe si janë, prandaj pyes a është publikuar edhe gjendja e tyre, dua përgjigje.

**znj.Saranda Stublla**, drejtoresh e DPKGJ, sërish i përgjigjet parafolëses duke theksuar se po është e obliguar Lista e përgjithshme e pronave komunale

**znj.Donjetë Sheqiri**, sërish insiston në pyetjen se a është publikuar gjendja e përgjithshme e pronave komunale duke theksuar se këtë e them sepse jeni duke menaxhuar me Drejtorinë

përkatëse që tri vite dhe nuk e keni përfillë ligjin duke mos e publikuar gjendjen e përgjithshme të pronave komunale. Pra edhe njëherë pyes pse nuk është publikuar.

**znj.Saranda Stublla**, drejtoresh e DPKGJ, sërish përgjigje parafolëses, theksoi, Lista e përgjithshme e pronave komunale është e publikuar dhe të gjitha të dhënat e parcelave janë të përfshira në atë Listë.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, meqë është fjala për këto prona komunale, zakonisht nëpër fushata zgjedhore po ngrisin shqetësimin se kur të vijmë në Kuvend Komunal do t'i mbrojmë interesat qytetare dhe pronën publike, kurse kur po vijmë këtu shpeshherë po ndodh sikurse në të kaluarën që po mbrohen interesa të individëve.

Ne siç e dim Klubi Futbollistik "Llapi" është një klub privat kurse për pronën për të cilën po flasim është pronë publike shoqërore, andaj nuk e di qysh dalim dhe interesohemi që kjo pronë të mos participoj dhe paratë nga lëshimi i asaj prone me qera të mos vijnë në llogari të Komunës, por të individëve privat.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, po mundohem të sqaroj për atë që kam memorje se ku është shndërruar KF Llapi ka qenë vitit 2017 sa kujtoj dhe edhe në atë kohë kemi pasë një bazë të pasqaruar juridike, dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, kurse tani këtu po na dalin pronë publike, pronë shoqërore e që po harrojmë se pronë shoqërore ka pasë vetëm në ish sistemin ngase në sistemin e tanishëm as që ka më pronë shoqërore, por unë mund ta kuptoj se nuk ka kujdes në terminologji, mirëpo po e përmbylli këtë duke theksuar se Komuna duhet të dal zotëse e pronës së vet, dhe askush nuk mund të ketë në posedim pronën komunale nëse të paktën nuk ka një marrëveshje, një kontratë me autoritetin e Komunës për shfrytëzimin e një prone të huaj, sepse ajo është një pronë e huaj për shfrytëzuesin dhe qoftë edhe me 1 euro ose me 0.50 cent, por ta din që nuk është pronë e tij, le ta din që duhet të paguaj për shfrytëzimin e diçkaje të huaj.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, mund të ketë edhe gabime dhe lëshime në terminologji shpeshherë, mirëpo tendenca që prona komunale të shfrytëzohet pa para dhe tjetërsimin e saj me tendencë, është shumë më e rëndë se sa gabimet terminologjike, kështu që të mos kapemi tek terminologjia por të kapemi tek thelbi i problemit.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, **z.Artrit Mulliqi**, në plotëni të përkraha në këtë, e potencova që terminologjia mund të jetë lëshim, por pronës komunale duhet t'i dilet zot, këtë e ceka dhe unë.

**znj.Saranda Stublla**, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, vetëm edhe një sqarim shtesë e kam lidhur me titullarin e pronës. Pronë shoqërore figuron në certifikatën e pronës mirëpo ky emërtim është prej vitit 1964 dhe nuk ka ndryshuar asnjëherë, do të thotë kjo pronë është e Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sigurisht që ka mbete sikurse në dokumentet e vjetra, madje edhe ne disa kemi probleme me pronat tona. Debati përfundoj dhe e vë në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje si dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur dje më 10.12.2024

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 20 anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 12 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan), miratohet propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes si dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.*

*Pas propozimit të znj.Tringa Sfishta për pauzë, Kryesuesi konstatoj se Njëzëri mbështetet që të shkohet në pauzë për 1 orë dhe atë nga ora 11:50 deri në ora 13:00, dhe njëkohësisht bëri thirrje që mbledhja vazhdon fiks në ora 13:00, të mos ketë vonesa.*

**Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 13:15.**

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori.

(Nga LDK Valon Demolli; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani.

Nga PDK, Bashkim Syla;

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

I pavarur, Adnan Zymeri.

Gjithashtu të pranishëm në mbledhje ishin, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës; drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

*(Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Vlora Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSSH dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).*

Të pranishëm tjerë ishin edhe përfaqësues të mediave lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

**5. Informatë e Punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, korrik-nëntor 2024**

**znj.Adelinë Stublla**, drejtoresh e DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj informata, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës është sipas Planit të Punës së Kuvendit ku është një informatë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, lidhur me pjesën e dytë të vitit për punët dhe projektet që janë përfunduar. Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ngërthen ndër vete një gamë të gjerë të shërbimeve, Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF dhe terrenin, Qendrat e terrenit, Shërbimin paliativ, Urgjencën dhe shërbimet tjera përcjellëse që kryhen brenda specialistikës dhe mjekësisë familjare.

Si çështje që duhet theksuar janë projektet që janë planifikuar dhe realizuar për vitin 2024, siç janë: furnizimi me barna projekt në realizim, furnizimi me pajisje, sistemi i menaxhimit të radhës për pacientët e QKMF-së projekt ky i mirëpritur nga qytetarët, pastaj furnizimi me oksigjen, furnizimi me pajisje mjekësore për shërbimet shëndetësore, servisimi i pajisjeve mjekësore, renovimi i objekteve shëndetësore dhe ambulancave në terren si dhe në qendër, furnizimi me dokumentacion mjekësor, ndërtimi i objektit të urgjencës së re, furnizimi me karrige gjinekologjike për personat me nevoja të veçanta projekt në procedurë të prokurimit, mandej mirëmbajtja e laurës, servisimi i automjeteve, larja e automjeteve, mirëmbajtja e klimave dhe nxemjeve.

Sa i përket shërbimeve shëndetësore, pa hyrë në detaje tani mjekësia familjare punon 24 orë, urgjenca e re ka filluar punën në datën e planifikuar me shërbimet përcjellëse, laborator, rëntgen 24 orë dhe stomatologji, vlen të theksohet se tani përveç ordinancës stomatologjike për persona me aftësi të kufizuara është edhe banjo për persona me aftësi të kufizuara.

Sa i përket Qendrës për Punë Sociale QPS, kryhet jashtëzakonisht një punë shumë e madhe e sidomos në kohët e fundit që ka raste jashtëzakonisht të shumta të dhunës në familje dhe divorcit, tani ky institucion ka edhe policinë për kujdes të sigurisë së stafit dhe palëve, objekti i QPS-së është rinovuar dhe ka marrë një pamje jashtëzakonisht të mirë.

Sa i përket mirëqenies sociale, Qendra Rezidenciale është një projekt në ndërtim e sipër tani planifikohet fillimi i ndërtimit të kulmit, shqyrtimi i kërkesave të palëve për strehim, pakove ushqimore dhe higjienike gjë që DSHMS varet prej donatorëve. Tri shtëpi janë të ndërtuara dhe janë në fazën e mobilimit për personat që kanë nevojë për strehim falë bashkëpunimit me Shoqatën e Halil Kastratit. Subvencionim me barna për personat me sëmundje të rënda po kryhen edhe pse kërkesat dita ditës janë në rritje, pastaj subvencionimi i OJQ-ve në shumë 20,000.00€ që janë Shoqata “Handikos” në shumë 9,500.00€, Shoqata e Autizmit në shumë 8,500.00€ dhe Organizata “OF AP” që është një organizatë për strehimin e fëmijëve e cila është subvencionuar në shumë 2,000.00€, dhe si informatë shtesë është se tash faktikisht veç kemi filluar me formimin e komisionit për pranimin e inventarit në Poliklinikën e re gjë që planifikohet së shpejti me shërbime specialistike. Në të gjithë sektorët që përfshihen në kuadër të DSHMS-së, po kryhet një punë e madhe falë punës, përkushtimit dhe bashkëpunimit me menaxhmentin dhe kështu dua t’i falënderoj zyrtarët komunal, punëtorët e QKMF-së së bashku me njësitë tjera përcjellëse për një punë dhe përkushtim të vazhdueshëm. Pres vërejtjet, sugjerimet në funksion të mbarëvajtjes së procesit më të mirë për sektorin e shëndetësisë.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, e falënderoj drejtoreshën e DSHMS-së për informatën dhe mbi të gjitha për korrektësinë që po tregon vazhdimisht ndaj neve duke u bazuar në atë se në vazhdimësi sjellë informata që ndërlidhen me Drejtorinë që ajo udhëheqë. Puna e saj është një punë shumë e mirë, është një angazhim shumë i madh, është shumë afër qytetarëve dhe është për çdo lëvdatë si dhe në të njëjtën kohë është një sukses i jashtëzakonshëm në funksionalizimin dhe ri funksionalizimin e Emergjencës së re të qytetit që është bërë një punë shumë e madh nga Drejtoresha në fjalë së bashku me stafin e saj. Ajo që ndoshta në të ardhmen presim më shumë është që të rritet stafi në QPS, përndryshe është duke bërë një punë shumë të mirë dhe vetëm vazhdoni kështu.

**znj.Tringa Sfishta**, theksoi, sot kam detyrë morale dhe publike të ngreh zërin kundër njërit prej dështimeve më të mëdha të kësaj qeverisje komunale dhe qendrore dhe situatës alarmante në sektorin e shëndetësisë në Podujevë. Për pesë vite me radhë qytetarët e Komunës tonë janë përballë me një mungesë të papranueshme të kujdesit shëndetësor të mbështetur vetëm në premtime boshe dhe mashtrime publike.

Spitali i Podujevës premtim që u zhduk, Spitali i Podujevës i premtuar me aq bujë nga qeverisja qendrore dhe komunale është zhdukë jo vetëm nga prioritetet e qeverisë por edhe nga dokumentet zyrtare përmes Statutit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës-SHSHKUK, dhe vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë për shfuqizimin e tij, kjo është një shuplakë e rëndë për qytetarët e Llapit të cilët detyrohen të udhëtojnë drejt Prishtinës për të marrë shërbime shëndetësore bazike. Ky është dështim total i kësaj qeverisje, një dëshmi e qartë e mungesës së përgjegjësisë dhe mos mbajtjes së premtimeve publike.

Poliklinika një tjetër mashtrim i madh, në vend të Spitalit u ofrua një zgjedhje e improvizuar një Poliklinikë dhe pas shtatë muajsh themelimit të saj ajo mbetet e pa funksionalizuar, as staf mjekësor, as aparatura e as shërbime, a është kjo zgjedhja që na është premtuar apo është një tjetër dështim dhe një tjetër mashtrim për t’i heshtur qytetarët dhe për të vazhduar dështimet tuaja.

Ju pyes publikisht, çfarë keni bërë për ta funksionalizuar këtë Poliklinikë apo është lënë edhe kjo të shkojë drejt një dështimi të sigurt njësoj sikur Spitali i Podujevës.

Gjendja e mjerueshme e ambulantave në fshatra, situata e ambulantave shëndetësore në fshatrat e Podujevës është një tjetër dështim, fshatrat si Halabaku, Dyzi, Hertica, Dobërdoli, Pollata, kanë ambulatat që janë pothuajse jashtë funksioni, me objekte të amortizuara, pa staf dhe pa pajisje bazike, qytetarët në këto zona janë lënë plotësisht në harresë pa qasje në shërbimet shëndetësore, “ciceronin” që e keni vendosur në krye të QKMF-së, a ka dhënë ndonjëherë ndonjë përgjigje për këtë situatë të mjerueshme, çfarë keni bërë ju si drejtoreshë e DSHMS-së për të përmirësuar këtë gjendje. Dështim me barna esenciale, furnizimi me barna esenciale veçanërisht nëpër ambulatat e fshatrave është në nivelin më të ulët të mundshëm, qytetarët detyrohen të blejnë vet barnat sepse ju nuk jeni në gjendje t’ia siguron ato.

Emergjenca e re, donacionet sikurse Emergjenca e re nga Katari janë i vetmi sukses i juaji nëse mund të quhet sukses, sepse sa i përket investimeve të juaja nuk keni bërë asgjë, por fatkeqësisht edhe në këtë donacion janë gjetur keqpërdorime të parasë publike ku auditori ka gjetur se janë shpenzuar rreth 250,000.00€ pa fatura dhe pa raporte të pranimit të punëve, kjo tregon qartë se as donacionet nuk arrini t’i menaxhoni si duhet duke i kthyer ato në shembull të keqpërdorimit dhe të pa aftësisë tuaj. Podujeva dhe qytetarët e saj për ditë e jetojnë degradimin që po ua bën qeveria qendrore dhe lokale, qytetarët tanë meritojnë shërbime shëndetësore të dinjitetshme dhe efikase, kjo qeverisje me pa aftësinë dhe neglizhencën e saj ka dështuar të përmbushë edhe nevojat më themelore të qytetarëve të Podujevës. Nuk mund të pranojmë justifikime sepse 5 vite janë tepër, andaj ndëshkimi për këtë qeverisje do të jetë i rëndë, i shpejtë por gjithsesi i merituar.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, po ndërlihem te informata e DSHMS-së, për atë që potencoi drejtoresha e DSHMS ku mes tjerash tha se Qendra Rezidenciale është afër finalizimit, unë e pyes fillimisht se në cilën fazë të punimeve është kjo Qendër, kur pritet të përfundojnë punimet dhe si është e mundur të hapen dhe të përfundojnë konkurset për rekrutimin e stafit për këtë Qendër kur ajo ende nuk është funksionale, me çfarë planifikimi financiar do të mbulohen ato paga për ata punëtor kur nuk ka objekt dhe nuk kanë ku të punojnë, ku do t’i zhvendosni ata punonjës për atë periudhë deri sa të hapet Qendra, përndryshe unë nuk e di si është e mundur të hapet konkurs për rekrutim të stafit për diçka që ende nuk është ekzistenciale sepse ende nuk kanë përfunduar punimet dhe si mund të funksionalizohet.

**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, e nderuar drejtoreshë e DSHMS vetëm përgëzime për punën e bërë deri më tani sepse me të vërtetë është punuar shumë dhe është ngritë cilësia e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, gjithashtu të falënderoj që nuk është duke u përdor strategjia e prerjes së shiritave për fushata siç është bërë traditë më herët me Spitalin e qytetit.

E nderuar drejtoreshë, në QPS pash statistika shqetësuese dhe nëse ky trend vazhdon kësaj dhe rritet, pra është fjala për rastet e reja të dhunës në familje që janë 34 raste të reja pastaj pashë 17 raste të reja ku të rinjtë janë në konflikt me ligjin, më intereson a është ndërmarrë apo është planifikuar të ndërmerret diçka në ndalimin apo në uljen e numrit të këtyre rasteve.

Po ashtu e pash kampanjën 16 ditore të aktivizimit kundër dhunës në familje, por nuk po besoj që është e mjaftueshme të lihet me kaq. Shqetësuese është edhe fakti ku në raport janë vetëm 9 raste të reja të çifteve që kanë kërkuar këshilla martesore, por në anën tjetër kemi shtim të numrit të divorceve andaj si qëndron çështja dhe si e ka planifikuar DSHMS ta trajtoj këtë çështje dhe të gjejë një zgjidhje sa më të mirë për evitimin e kësaj dukurie.

**znj.Adelinë Stublla**, drejtoresh e DSHMS, theksoi, e falënderoj secilin për falënderimet, sugjerimet, vërejtjet, kritikën dhe lëvdatat. Sa i përket çështjes së asamblistit z.Ragip Fetahu, faleminderit Ragip për të gjitha ato që i ceke në lidhje me çështjen e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, ndërsa sa i përket çështjes së asambleistes nga radhët e LDK-së znj.Tringa Sfishta që tha faktikisht dështim total, më vjen keq së pari për profesionin që e ka që është punëtore shëndetësore dhe mundet me thënë këtë çështje pasi besoj se së shpejti ajo diplomon dhe e pret ky institucion kështu që ne e mirëpresim për punën dhe kontributin që ka për të treguar për qytetarët e këtij vendi. Sa i përket mungesës së shërbimeve shëndetësore, faktikisht ne në QKMF ashtu siç e kam cek në raport dhe materialin që e keni para vetës i kam cek gjitha shërbimet që kryhen si në QKMF ashtu edhe në terren dhe ambulancat përcjellëse. Pastaj e cekët që puna e Spitalit u hapë e u mbyllë, ne e dimë prej të kaluarës sepse jemi qytetarë të këtij vendi, sa herë iu ka pre shiriti Spitalit, kurse sa i përket punës së Poliklinikës që the mashtrim, unë veç e ceka se është formuar komisioni për pranimin e inventarit si dhe kanë filluar procedurat e prokurimit për blerjen e pajisjeve përcjellëse për shërbimet specialiste.

Sa i përket ambulancave të terrenit, nuk qenke informuar sa duhet për të gjitha këto që i ceke, realisht disa prej tyre që tash s'po dua të përmirësoj meqenëse ke dashtë me hy në detaje dhe është dashur të hysh tamam në detaje ashtu si duhet, disa prej tyre punojnë, janë rinovuar dhe janë të gjitha me pajisje të përshtatshme për personelin dhe për pacientët që marrin shërbimin.

Sa i përket ambulancave që veç i ceke, ne kemi shërbimin paliativ që faktikisht punon deri në ora 23:00 duke iu ofruar ndihmë gjithë atyre pacientëve që kanë nevojë për trajtimin apo marrjen e një këshille mjekësore apo shërbimi shëndetësor kështu që paliativi punon deri në ora 23:00 dhe mbulohet e gjithë Komuna e Podujevës.

Sa i përket drejtorit të QKMF-së që e cekët diçka si "ciceron" ai realisht është duke kryer një punë jashtëzakonisht të mirë dhe jam falënderuese dhe mirënjohëse për punën që ai bënë, bashkëpunimi që kam unë me të po ju dhemb gjithsecilit e sidomos disa shokëve dhe kolegëve tuaj që tash faktikisht ju kanë ndalë pazaret si dhe daljet në orar të punës nëpër kafe, dhe kjo është pak si bezdisëse për të gjithë ata sepse e di qysh ka qenë më herët sepse kam qenë aty, por megjithatë unë vetëm i uroj punë të mbarë, rend dhe rregull për të gjithë ata që duan punë.

Sa i përket Urgjencës që thatë është donacion prej Katarit, ne jemi në bashkëfinancim veç nëse nuk e ke ditë ta shpjegoja, ndërsa sa i përket furnizimit me barna, më vie tepër keq që u shprehe ashtu sepse faktikisht edhe në nivelin qendror dhe në nivelin lokal kemi furnizim nga Ministria dhe nga Lista esenciale që faktikisht e kemi kontratën ashtu siç e ceka edhe më herët. Te Urgjenca the që faktikisht janë bërë disa pagesa e shumë nuk e mbajta në mend dhe e ceke Auditorin mirëpo realisht ne nuk kemi bërë raport të përmbylljes të të gjitha procedurave, me raportin e përmbylljes të të gjitha procedurave jepet pasqyra adekuate.

Sa i përket çështjes së asambleistit z.Arjant Topanica e falënderoj për çështjen e ngritur rreth Qendrës Rezidenciale, e tregova se deri ku ka shkuar projekti, tash është në fazë të kulmit, do të thotë janë bërë ndarjet në mes të dhomave, projekti ka për të qenë tepër i mirëseardhur për qytetarët, sidomos në kohën e sotit që faktikisht në shumicën e vendeve siç tregojnë këta të shërbimit paliativ që po e gjejnë faktikisht një plak ose një plakë si në kohët e më hershme, kështu që është e nevojshme për këtë kategori meqë janë të anashkaluar dhe kanë nevojë për socializim sidomos me bashkëmoshatarët e tyre, ndërsa sa i përket çështjes së stafit, ne e kemi ndarë kodin buxhetor në vitin e kaluar dhe për mos me na humb ai kod buxhetor, meqenëse kemi mungesë jashtëzakonisht të madhe të stafit dhe rritje të shërbimeve atëherë atë staf që e kemi rekrutuar e kemi fut në funksion në QKMF deri në realizimin e projektit të Qendrës Rezidenciale dhe në momentin që realizohet ai projekt, ai staf kalon që Qendrën e Rezidenciale.

Sa i përket çështjes së asamblistit z.Xhevdet Maloku edhe këtë e falënderoj për të gjitha ato që i potencoj për çështjen e shëndetësisë, lidhur me punën e QPS-së, atje kryhet një punë jashtëzakonisht e madhe falë punës dhe përkushtimit të të gjithë zyrtarëve së bashku me drejtoreshën e QPS-së, është një punë që faktikisht nuk mund të bëhet bujë mediatike për shkak të rasteve që faktikisht trajtohen atu. Është shqetësuese rritja e rasteve të dhunës në familje por faktikisht edhe divorceve mirëpo mund të shprehem në thonjëza se kjo tashmë është bërë trend, a kanë ndërmarr diçka apo jo faktikisht ata janë duke kryer punën e tyre, në fakt mendoj se duhet të ketë trajnime dhe kampanja sa më shumë në mënyrë që të mos jetë vetëm ky 16 ditshi por të ketë edhe këshilla të tjera për këto çështje.

Sa i përket këshillave martesore që kanë marrë vetëm 9 persona, ne normalisht secilin çift e inkurajojmë për çështjen e këshillave por realisht nuk mund t'i sjellim me dhunë për t'iu dhënë këshilla, kështu që faktikisht secili prej tyre e sidomos të rinjtë kanë nevojë për këshilla por megjithatë ajo është nën kujdesin e secilit se a don apo jo.

**znj.Edona Shabani**, theksoi, e nderuar drejtoreshë e DSHMS-së, dua t'ju them që në të kaluarën ka ndodh çka ka ndodh dhe unë nuk jam ajo pjesë e qeverisjes së kaluar, mirëpo as në të tashmen nuk është duke u bërë diçka më mirë, për atë je drejtoreshë dhe bëje më mirë atë që ka qenë gabim në të kaluarën. Ndodhë edhe sot që mjekët ose infermierët në Komunën tonë janë në gjendje me lënë punën dhe pacientin jashtë, e me dalë për cigare edhe pse nuk shkon në kafe por e porositë kafën dhe del pin cigare në orar të punës. Ndoshta nuk je e informuar për të gjitha këto por besoj se të gjitha këto do t'i faktoj dhe do e shohësh se nuk është më mirë se në të kaluarën.

**znj.Tringa Sfishta**, theksoi, drejtoresha znjAdelina Stublla ma përmendi emrin dhe tani thash të bëjë up-date sepse si duket ka mbetë me informacione të vjetra, kur të hapet konkurs për specializantë atëherë unë aplikoj dhe mund të bëhemi kolege. Rreth asaj që e tha, pasi që ke hy në detaje po t'i shpjegoj gjitha detajet, atëherë ti nuk e bërë asnjë detaj, andaj pra po ia nisim kështu, a po më tregon sa i përket Urgjencës së Qytetit cilat shërbime ofrohen dhe sa është numri i mjekëve specialistë, infermierëve, numri i auto ambulancave, çka do bëhet me objektin aktual të emergjencës për çka do shfrytëzohet pasi që flitet se do bëhet Qendër e Shëndetit Mendor e që e kundërshtojnë qytetarët e Komunës së Podujevës një gjë të tillë.

Pastaj si është e mundur të zhvillohen procedurat e rekrutimit për personelin mjekësor kur Qendra Rezidenciale nuk është funksionale, kush është organi kompetent për zhvillimin e këtyre procedurave, kush do i nënshkruaj kontratat për këtë personel mjekësor dhe pse është pranuar ta fillojë punën në Qendrën Rezidenciale, a është bërë planifikimi buxhetor kur do të fillojnë punën këta punonjës pasi që Qendra Rezidenciale nuk është funksionale kurse ju keni zhvilluar procedura të konkurrimit dhe keni shpallë rezultate për këtë personel mjekësor, mbi cilën bazë ligjore ju do i transferoni këta punëtor në QKMF ose AMF të Podujevës dhe kush do mbajë përgjegjësi morale dhe penale për këtë çështje.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, e kuptoj gjithë debatin sepse jemi në prag të një fushate zgjedhore dhe secili tenton ta shpërfaq atë vetveten e tij, e kuptoj edhe kolegen znj.Tringa Sfishta por e them se i ka lexuar ato shkrime mjaftë mirë që i ka formuluar, realiteti është se mua më ka ra rasti me një projekt tjetër të shkoj në ambulancat nëpër fshatra dhe i kam shikuar vetë të gjitha, ata nuk vuajnë për staf, higjienë, furnizim me barna dhe elemente tjera, mirëpo fakti është se kanë pak pacientë, do të thotë këtu qëndron problemi, nuk qëndron problemi i stafit dhe gjërave tjera që u ceken.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, fillimisht po ndërlidhem te parafolësi i fundit të cilit do t'i thoja që kur të flet ai a bënë me thënë diçka konkrete a veç me fol kështu sipërfaqësisht për të tjerët.



**Kryesuesi i Kuvendit**, duke ndërhyrë, theksoi, i nderuar Arjant nuk jemi ne këtu për ta vlerësuar njëri tjetrin, por të fokusohemi në temë.

**z.Arjant Topanica**, vazhdoi, tanë po ndërlihem te drejtoresha e DSHMS-së sa i përket Qendrës Rezidenciale për të cilën do të doja ta di kur do të bëhet funksionalizimi i saj dhe kur shihet sa larg është funksionalizimi i saj përse ta ngarkoni buxhetin me kod buxhetor për punonjës dhe të hapni konkurs për diçka që shihet se nuk është afër të filloj punën, pra qëllimi si duket ka qenë, të hapim konkursin, t'i kryejmë procedurat, t'i marrim njëherë punëtorët e tani i dërgojmë ata ku të kemi nevojë, e them këtë sepse është diçka e prekshme dhe duket se Qendra Rezidenciale nuk është gati dhe nuk është dashur të bëhet planifikimi buxhetor e as të hapen procedurat e rekrutimit përderisa nuk është gati Qendra, për çka ka me u rekrutuar ai staf.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, u zgjat paksa debati dhe nuk e pata ndër mend ta marrë fjalën me vetë faktin se drejtoresha e DSHMS-së na ka respektuar dhe të paktën po vjen e po jep informatë ashtu siç i takon e jo sikur ata kolegët e saj që po ikin, prandaj këtë e vlerësoj.

Te punët e shëndetësisë nuk jam i fushës por unë e përcjell prokurimin dhe më bëjnë përshtypje shumë tenderët që jepen atje, këtu në informatë herëve tjera kisha thënë të na sqaroni servisimin e aparaturës mjekësore që ka shumë dhe nuk e dimë kush po i prish aq shpesh ato pajisje mjekësore e as përse po del aq shpesh ky tender. Ka pas tender për sigurim të veturave dhe kam parë shumë shpesh që janë anuluar tenderët, mandej ky tenderi i laurave që del aq shpesh, dhe tjetër që më ka bërë përshtypje ka qenë edhe puna e klimave se një herë kam hy në një dosje të një tenderi dhe e pashë 36 klima për 36 mjek, unë nuk e di a janë 36 a jo, nuk spekuloj se nuk e di por mu duk shumë sepse shumë shpesh bëhet servisimi i tyre, pastaj ka tender edhe për asgjësim të barnave e që është shumë i ndjeshme për çka herën tjetër do të doja të kemi një raport më të detajuar se ku asgjësohen ato barna, a bëjnë dëm dhe a mbesin nëpër qytet, si dhe për pajisjet mjekësore.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, shkurt po i përgjigjem kolegut tim, e vlerësoj mendimin e juaj mirëpo para se ta japim një mendim çdo herë duhet t'i përdorim përemrat pyetës kush jam unë, çka bëjë unë dhe pse e them unë.

**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, e falënderoj drejtoreshën e DSHMS-së për përgjigjet, por deshta vetëm një plotësim të bëjë sepse unë e di që me dhunë nuk mundesh me sjellë çiftet me marrë këshilla martesore, mirëpo a është marrë ndonjë iniciativë sikurse kjo kampanja 16 ditore kundër dhunës në familje, ngase unë një kampanjë të tillë nuk e kam parë.

Po ashtu edhe një pyetje e kam rreth ambulantes në fshatin Lluzhan, a do të vijë vetura e ambulantes, a do të furnizohet QMF-ja në Lluzhan a po jo.

**z.Haki Rudari**, theksoi, ne kemi një informatë nga DSHMS dhe në këtë informatë janë përfshirë shërbimet që iu kanë ofruar qytetarëve, ka shumë dhe për të mos ju lodh unë po i lexoj vetëm dytri prej tyre, radiologjia ofron shërbime nga ora 17:00 deri në ora 23:00, madje çdo ditë pune, festave dhe vikendeve për çka mendoj se është një shërbim në interes të qytetarëve respektivisht të pacientëve. Pastaj Laboratori në qendër punon nga ora 07:00 deri në ora 23:00, çdo ditë pune, festave dhe vikendeve, për çka edhe për këtë mendoj se këto shërbime janë në interes të qytetarëve. Ka edhe shumë shërbime tjera por unë po ndalem te lloji i shërbimeve ndër të tjera që janë vizitat sistematike në Çerdhet publike dhe në shkolla që janë paraqitur në 6 mujorin e parë dhe në 6 mujorin e dytë, këto vizita ende nuk janë bërë drejtoreshë, andaj a vazhdojnë këto pasi janë në interes këto kontrolla pasi që vet vije nga fusha e arsimit dhe besoj se është shumë e mirë dhe shumë pozitive vizita qoftë në Çerdhe apo në shkolla e sidomos në shkollat fillore.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, sërish po ndërlihem aty ku e lamë bisedën për me pyet kush jemi, nga vijmë e çka bëjmë, kjo bisedë është me parafolësin, ne të gjithë e dimë dhe nuk është fortë e drejtë ta vlerësojmë vetën sepse të tjerët na vlerësojnë dhe na njohin, unë vetëm thash që e di se është admirues i filozofisë, por nganjëherë duhet me fol diçka konkrete e jo vetëm sa për të thënë diçka ashtu.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, s[ri]sh të drejtohem ty z.Arjant Topanica, ju jeni dy drejtime, ekonomi dhe filozofi, dhe nuk po mund të kuptoheni.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, edhe një pyetje e kam për drejtoreshën e DSHMS-së ngase u përmend shumë rekrutimi. Unë në bazë të asaj çka kam lexuar dhe dëgjuar, me regjistrimin e ri tash që jemi Komuna e dytë që kemi rënje më së shumti të numrit të banorëve dhe tani statistikën e japin që kemi punëtor shëndetësor më shumë në bazë të numrit të popullsisë, unë nuk e di si e bën kjo, unë e di që ka ende nevojë dhe nëse prej vitit 2025 kjo funksionon në bazë të regjistrimit të popullsisë do të jetë problem.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, unë kam qenë në një konferencë që ka qenë rreth zvogëlimit të popullsisë nëpër komuna dhe të gjithë Kryetarët e Komunave e kanë këtë problem sepse edhe ndarja e buxhetit bëhet për kokë banori, prandaj do kemi edhe telashe, madje në atë takim edhe Kryetari i Komunës së Vitisë e ceku se gjatë verës në Viti ka dyfishim të numrit të banorëve të cilëve duhet t'ju ofrohen shërbime shëndetësore, në komunikacion, në mirëmbajtje ujësjellës e të gjitha, kështu që nëse buxheti zvogëlohet komunat do të kenë telashe shumë të mëdha sepse kur po e kemi fluksin e madh gjatë verës po e shohim që kemi një mbingarkesë.

Unë drejtoreshën e DSHMS-së vetëm e përgëzoj për punën që ka bërë dhe e falënderoj për informatën që na e ofroj.

**znj.Adelinë Stublla**, drejtoresh e DSHMS, theksoi, falënderoj Kryesuesin e Kuvendit për vlerësimin e dhënë, ju mbeta borxh disave që faktikisht bën pyetje pasi që dhashë përgjigje unë, znj.Edona Shabani asambleiste nga radhët e LDK-së e tha një shprehje, bëje atë më mirë që s'ka qenë më herët, unë them se jemi në mundim e sipër dhe të falënderoj për këtë çështje që veç e ngrite, çdo ditë mundohemi për atë që ta bëjmë sa më mirë dhe atë jo vetëm në sektorin e shëndetësisë por në të gjitha sektorët që prekin qytetarët. E thash se stafi mjekësor nuk dallon prej herës së kaluar, dhe nëse nuk del jashtë rrinë brenda pinë cigare dhe kafe, e thatë që e dokumentoni këtë andaj kisha pas qejf me ma dokumentuar këtë por si do që të jetë mbi të gjitha jemi njerëz dhe kemi nevoja të ndryshme qoftë edhe për ata që pijnë cigaren dhe kafën, nuk është gjë nëse e pinë një cigare ose një kafe, unë faktikisht nuk dua t'ia mohoj këtë edhe pse s'është e drejtë sepse është koha e pauzës por mbi të gjitha jemi njerëz dhe lodhja e bënë të vetën dhe më mirë është ai të freskohet pak dhe të jetë shumë më i mirë në shërbimin ndaj qytetarit ose pacientit por realisht duhet të ketë parasysh që pacienti të mos pres gjatë kësaj kohe në korridor.

Sa i përket çështjes së znj.Tringa Sfishta që më tha paske mbet me të vjetrën, më vie keq zonja Tringa se goxha kohë nuk kemi ndej së bashku kështu që të përgëzoj për punën që ke arritur me suksese në sektorin e shëndetësisë ngase tash qenke specializante kështu që faktikisht të uroj shumë suksese dhe të priftë e mbara në Poliklinikë së bashku me specialistët e tjerë.

Sa i përket çështjes të Urgjenca e vjetër që pyete çka ka me u bë e çka ka me mbet, realisht është duke u zhvilluar puna e kujdestarisë së natës me që objekti i urgjencës ka një distancë kështu që kemi planifikuar me kujdestari të natës, ndërsa se a do të jetë Qendër e Shëndetit Mental apo jo realisht nëse veç vendosim unë e sjellë në Kuvend si çështje dhe ju e votoni po ose jo, sepse ajo çështje duhet të kalojë përmes Kuvendit për të kaluar objekti në kuadër të shëndetit mental.

Sa i përket çështjes së Qendrës Rezidenciale, konkursi veç se i tregova z.Arjant Topanicës dhe s'kisha dashur fortë të ndalem në këto çështje, kurse sa i përket çështjes së ngritur nga po ashtu

zotëri Topanica që pse nuk është hapë, pse është bërë tash e nuk është bërë më herët dhe pse kaq herët për shkak se nuk është në përfundim Qendra Rezidenciale, realisht ne jemi vonuar me çështjen e Qendrës Rezidenciale për shkak se njëherë nuk është bërë marrëveshja me kohë sepse është varë prej donatorit dhe nuk është varë prej Komunës. Pastaj çështja e parcelës që faktikisht ju keni dalë me disa postime jo po e zë, jo s'po e zë objektin e Qendrës Rezidenciale, çështje këto të cilat paksa kanë qenë problematike por megjithatë ajo parcelë e zuri objektin dhe shumë mirë është kjo, dhe faktikisht veç e kalofshin sa më mirë kohën ata të moshuarit aty.

Sa i përket çështjes së ngritur nga z.Ekrem Rrahmani i cili faktikisht nuk qenka prezent tani në sallë, i cili më falënderoj se kam sjellë informatën, unë e ndjej obligim meqë ju jeni të zgjedhur të popullit, kam qenë edhe unë 3 mandate asambleiste dhe faktikisht kam kërkuar raporte dhe çështje tjera prej drejtorëve të drejtorive sa isha në opozitë dhe në momentin që kam kërkuar asnjëherë nuk më janë përgjigjur, ju realisht edhe pse nuk më keni kërkuar informatë unë e ndjej obligim për aq sa di dhe sa mundem me qenë sa më korrekte.

Sa i përket çështjes së klimave që u cek se janë 36 klima, realisht në gjithë terrenin dhe në këto njësitë përcjellëse të mjekësisë familjare ka klima gjë që faktikisht neve na kanë bërë shumë mirë tani për shkak se kemi pas mungesë të ngrohjes me pelet, kështu që faktikisht jemi gjind me klima dhe normalisht ato kur punojnë duhet edhe të servisohen.

Po ashtu edhe për punën e pajisjeve mjekësore që e ceku z.Ekrem Rrahmani, realisht në momentin kur ka punë edhe pajisjet mjekësore dëmtohen kështu që nevojitet një riparim apo rregullim i tyre.

Sa i përket çështjes së parashtruar nga z.Xhevdet Maloku për çështjen e autoambulancës në fshatin Lluzhan, ne faktikisht me këtë konkursin e fundit që nëse nuk gaboi është faza e testimi dhe sa kujtoj do të bëhet në fund të javës, dhe me rekrutimin e këtij stafi po mendojmë që në vitin e ardhshëm edhe pse nuk e di sakt a kemi planifikuar apo jo pa qenë çështja e sigurt, faktikisht do ta bëjmë Lluzhanin 24 orë me autoambulancë dhe me staf teknik të trajnuar për çështjen e dhënies së ndihmës së parë.

Sa i përket çështjes së ngritur nga z.Haki Rudari duke falënderuar atë për të gjitha ato sqarime që i potencoj lidhur me shërbimet shëndetësore, unë realisht disa i përmenda por në disa prej tyre nuk deshta të ndalem në detaje për shkak se secili e keni materialin para vetes, pra ishin laboratorit, rëntgeni siç u cek që punon deri në ora 23:00 tani, por Urgjenca punon 24 orë.

Sa i përket vizitës nëpër shkolla, kam raportuar në raportin e mëhershëm që janë kryer gjitha vizitat në shkolla dhe në Çerdhe dhe tash besoj që së shpejti do të formohet një ekipë dhe do të vazhdojnë me punën e tyre me vizita në shkolla dhe në Çerdhe.

**znj.Edona Shabani**, theksoi, si duke drejtoresha parafolëse më ka keqkuptuar, unë nuk jam për t'ia cenuar të drejtën askujt për të dal me pi cigare apo kafe, mirëpo nuk ka të drejtë sepse nuk e ka marrë me "tapi" atë vend që ta qes pacientin jashtë zyrës dhe t'i marrë cigaret e të dal jashtë, pra ai ose ajo nuk e ka asnjë të drejtë të veprojë në atë mënyrë me pacientin i cili ka nevojë për atë shërbim mjekësor. Pra atë që e ceka nuk e thash për t'ia cenuar ti të drejtën askujt për cigare ose kafe, ai / ajo le të pinë tërë ditën, por jo të bëjë sjellje të tilla idiote me qytetarët tanë.

**z.Valon Demolli**, theksoi, po ndërlihem te drejtoresha e DSHMS për shkak se shumë u përmenden shokë tonë, ne kemi shumë shokë edhe në QKMF, mirëpo disa prej shokëve tanë aty janë disa shokë që po persekutohen nga drejtori "ciceroni" i QKMF-së kurs disa servilë të "ciceronit" po kanë kohë të qëndrojnë po thujse në vëzhgim sikurse kamera të vëzhgimit nën dirigjimin e tij, ata kanë kohë të përcjellin secilin ku shkon e çka bënë, ndërsa shokët tanë jeni duke i persekutuar. Mos të harrojmë që punësimet nuk u përmenden këtu, prej Kryetarit të Komunës e deri te ky "ciceroni" krejt familjarët i keni punësuar, veç thashë t'jua përkujtoj që të mos harrojmë.

**znj.Adelinë Stublla**, drejtoresh e DSHMS, theksoi, e nderuar znj.Edonë Shabani sa i përket asaj çështje që e ceke që nuk kemi të drejtë askujt t'ia cenojmë të drejtat, po është e vërtetë, ndërsa sa i përket asaj që e the se ka nxjerrë pacientin jashtë prej ordinancës, këtë kisha pas qejf fort të ma dokumentosh dhe faktosh në mënyrë që pastaj unë të merrem me këtë çështje edhe pse janë kamerat e vendosura dhe mundemi me i kthye dhe me pa sakt.

Sa i përket çështjes së potencuar nga asambleisti z.Valon Demolli, duke falënderuar atë për të gjitha ato që i ceku e them se po ne kemi shokë, shoqe sepse jemi banor të këtij vendi dhe realisht Podujeva nuk është vend shumë i madh, secili prej nesh aty mund të kemi edhe familjar madje, por sa i përket punës së punësimeve e dimë këtë çështje, e dini edhe ju kështu që nuk kisha dashur të ndalem në detaje, të gjithëve i'u uroj punë dhe suksese në të mirë të qytetarëve sepse shëndetësia nuk është veç e pozitës por është edhe e opozitës dhe në shëndetësi besoj që nuk duhet të ketë ngjyrimet politike.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, pra me kaq e mbyllim debatin për këtë pikë të rendit të ditës, besoj që drejtoresha e DSHMS-së i dha përgjigjet e mjaftueshme, po ashtu edhe anëtarët e Kuvendin ishin mjaftë të angazhuar, kështu që e konstatojmë të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës dhe vazhdojmë me pikën e radhës.

## **6. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

**znj.Lirie Hoti**, drejtoresh e DBPZHR, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj informate, theksoi, sot kam kënaqësinë që këtu para jush dhe qytetarëve që po na ndjekin të prezantoj dhe të flasë lidhur me projektet të cilat ne si Drejtori i kemi realizuar në vitin 2024, andaj në fund të raportimit unë mirëpres po ashtu edhe pyetjet e juaja si dhe kritikën dhe sugjerimet në qoftë se keni.

Fokusi kryesor i DBPZHR-së për këtë vit sigurisht kanë qenë investimet në fushat e pemëtarisë sidomos në pemët e imëta me theks të veçantë në mjedër dhe dredhëz pastaj në perimtari, blegtori dhe bletari andaj disa nga projektet që ne i kemi realizuar janë si në vijim:

Kemi bërë përkrahjen e fermerëve me fidanë të mjedrës ku në këtë projekt janë përkrahur gjithsej 4 fermer me nga 1100€ vlerë monetare në formë të subvencionimit pagesë direkte, qëllimi kryesor i këtij projekti ka qenë ngritja e pemishteve moderne me mjedër si dhe rritja e kapaciteteve prodhuese në sektorin e pemëve të imëta.

Pastaj si projekt tjetër kemi pas përkrahjen e fermerëve me fidanë të feferonave ku gjithsej në kuadër të këtij projekti është bërë përkrahja e 10 fermerëve me nga 500€, vlerë monetare në formë të pagesave direkte, qëllimi kryesor ka qenë mbështetja e fermerëve dhe rritja e sipërfaqeve të mbjella me perimëkulturë.

Projekt tjetër i realizuar është edhe përkrahja e fermerëve me fidanë të dredhëzës, sistem të ujitjes dhe me foli ku në kuadër të këtij projekti kemi bërë përkrahjen e 4 fermerëve me subvencionim në vlerë 1500€, vlerë monetare në formë të pagesave direkte, qëllimi kryesor i këtij projekti është ngritja e pemishteve moderne me dredhëz si dhe rritja e kapaciteteve prodhuese në sektorin e pemëve të imëta.

Sigurisht që projekte tjera të realizuara në perimekulturë, furnizimi dhe montimi i serave për fermerët ku kësaj radhe në këtë sektor ne kemi bërë ndarje në dy kategori, kemi bërë përkrahjen me sera të mëdha dhe sera të vogla me qëllim që t'i përkrahim edhe fermerët të cilët duan të prodhojnë për treg si dhe të përkrahim fermerët që duan të prodhojnë vetëm për nevojat familjare, dhe në kuadër të këtij projekti kemi përkrahur 85 fermer me sera të madhësisë 50m<sup>2</sup>, si dhe 35

fermer me sera të madhësisë 500m<sup>2</sup>, në këtë mënyrë është kontribuar në përmirësimin e kushteve të punës së fermerëve duke krijuar kushte në gjenerim të të hyrave më të mëdha dhe vetëpunësim nga aktivitetet e tyre.

Projekt tjetër të realizuar me sukses kemi pas edhe furnizimin me mekanizëm bujqësor ku kësaj radhe për herë të parë është bërë furnizimi me mekanizëm bujqësor në 7 lloje duke u përkrahur kështu 103 fermer me këtë lloj të mekanizmit, makina pneumatike për mbjellje të grurit, makina mekanike për mbjellje të grurit, freza 1.8, pllugj, motokultivator me frezë, frezë për motokultivator 12hp, makinë për shtrirje të folisë plastike sistemit pikë pikë dhe mbjelljes së fidanëve të perimeve, e që sigurisht qëllimi i këtij projekti ka qenë rritja e kapaciteteve prodhuese të kulturave bujqësore përmes përgatitjes më cilësore të tokës.

Një projekt tjetër të realizuar në kuadër të DBPZHR-së për këtë vit edhe atë në sektorin e blegtorisë ku këtë vit ne kemi bërë përkrahjen e fermerëve me 154 mëshqerra, pra janë përkrahë 154 fermer me nga një mëshqerrë mbarëse, qëllimi kryesor ka qenë mbështetja e fermerëve në avancimin dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese si dhe rritjen e numrit të gjedheve. Kur jemi te ky projekt vlen të ceket se kemi pas interesim të madh të fermerëve të cilin e kemi zhvilluar në kuadër të Drejtorisë.

Po ashtu në këtë vit kemi arrit që me shumë sukses të realizojmë edhe projektin në sektorin e bletarisë, furnizim me pajisje për bletë, thirrja ka qenë e hapur që të bëhet përkrahja e 17 fermerëve me duplikator elektrik 120 litërsh, po ashtu edhe 20 fermerëve me nga 5 koshere anti varo, realisht ne kemi bërë vetëm shpërndarjen dhe furnizimin tashmë të njërit prej grupeve, pra kemi bërë shpërndarjen e koshereve ndërsa këto ditë do të bëhet edhe shpërndarja e duplikatorëve.

Projekt tjetër jo më pak i rëndësishëm e kemi edhe lansimin e platformës së tregut online e cila platformë e këtij lloji është e para në Kosovë, këtë platformë ne e kemi lansuar në muajin maj të këtij viti, përmes kësaj platforme iu mundësohet të gjithë fermerëve të Komunës tonë të regjistrohen falas dhe të bëjnë promovimin e produkteve që ata kultivojnë dhe përpunojnë, kjo platformë është krijuar për të mbështetur fermerët dhe funksionon si një treg i gjelbër online e cila mbikëqyret nga DBPZHR, qëllimi kryesor është krijimi i mundësisë më të lehtë të ekspozimit të produkteve të cilat i kultivojnë fermerët Llapjan.

Përveç projekteve të cilat ne i kemi realizuar me buxhetin e paraparë për vitin 2024 në kuadër të Drejtorisë ne kemi realizuar edhe projekte tjera në bashkëpunim si me Ministrinë e Bujqësisë ashtu edhe me organizatat të cila do i ceku në vijim, pra së bashku me Ministrinë e Bujqësisë zyrtarët e DBPZHR-së kanë qenë të angazhuar në thirrjen për aplikim për pagesa direkte për litër të qumështit sipas kategorive të cilësisë, thirrje të raportuarit e gjedhit, viçat për majmëri dhe agrikulturat për 6 mujorin e dytë të vitit 2023. Nga kjo thirrje janë pranuar gjithsej 82 aplikacione të fermerëve të cilat janë proceduar për shqyrtim dhe miratim në MBPZHR, ndërsa thirrja për 6 mujorin e parë për vitin 2024 ka qenë e hapur nga data 01.08.2024 deri më 01.09.2024, në këtë thirrje kemi pranuar 48 aplikimi të cilat po ashtu janë dorëzuar në MBPZHR.

Thirrje tjetër ka qenë për mbështetje përmes programit për pagesa direkte për kulturat dhe aktivitetet bujqësore për vitin 2024, ku janë pranuar gjitha aplikacionet për fermerët të cilat janë përcjellë në MBPZHR dhe një pjesë e tyre tashmë është realizuar ndërsa pjesa tjetër ndodhet në monitorim dhe verifikim në terren.

Thirrje tjetër në kuadër të MBPZHR-së kemi pas atë për aplikim për përkrahje të pjesësme të plehut artificial për grurë, farë gruri, elb, thekër, tërshërë, misër, patate, lule dielli dhe fasule monokulturë, sigurisht aplikacionet nga ky aplikim janë dorëzuar në MBPZHR dhe të gjithsej i kemi pranuar 1085 aplikacione.

Po ashtu tani së fundmi patëm thirrjen për aplikim për pagesa direkte për kilogramët e shitur të mjedrës në të cilën thirrje deri në datën e përpilimit të këtij raportimi kanë qenë të raportuara 144 aplikime të fermerëve të cilat tashmë janë dorëzuar në Ministri.

Sigurisht që më parë e ceka se kemi bashkëpunim me organizatat tjera ku kemi realizuar një projekt me Organizatën IADK-në, projekt ky në realizim e sipër, mandej kemi pas thirrjen për përkrahje të fermerëve me grande për ndryshimet klimatike dhe digjitalizim të bujqësisë me theks të veçantë e kemi pas fokus në blegtori dhe hortikulturë ku janë dorëzuar aplikimet në organizatën IADK dhe po presim vetëm të bëhet vlerësimi dhe të bëhet publikimi i listave përfituese.

Sigurisht që në kuadër të DBPZHR-së janë zhvilluar edhe aktivitete tjera si vizitat në terren të fermerëve, komunikimet e përditshme me fermer, dëgjimi i ankesave të tyre dhe dhënia e kahjeve të ankesave të cilat ata na i prezantojnë.

Pak a shumë ishte një raport i këtij viti me punët e realizuara dhe projektet në kuadër të DBPZHR të cilën unë e përfaqësoj dhe nga kjo foltore po e shfrytëzoj rastin edhe njëherë të përsëritur dhe të përgëzoj gjithë fermerët Llapjan për punën të cilën ata janë duke bërë, për punën e tyre të pa lodhshme, angazhimin dhe vullnetin që po shprehin si dhe njëherit nga kjo foltore jap zotimin tim që do të bëjmë të pa mundurën që t'i përgjigjemi kërkesave të tyre dhe të jemi në përkrahjen e tyre. Për fund falënderoj gjithë zyrtarët e DBPZHR-së dhe zyrtarët e tjerë komunal që kanë qenë të angazhuar në realizimin e këtyre projekteve këtë vit, jam e hapur për pyetjet e juaja.

**znj. Sebastina Vokri**, theksoi, fillimisht e falënderojmë drejtoreshën parafolëse për këtë informatë dhe në parim ne si Grup i LVV-së e mbështesim pasi jemi të vetëdijshëm që një numër i madh investimeve janë bërë në bujqësi si në fushën e pemëtarisë, perimtarisë, blegtorisë, bletarisë, janë realizuar edhe shumë projekte gjatë vitit 2024, mirëpo po e shfrytëzoj rastin të bëjë një thirrje për një mbështetje më të fuqishme ndaj familjeve që po përballen me sfidën e pa punësisë.

Kemi raste që një fermer i cili nuk e ka asnjë të punësuar në familje ka aplikuar dhe nuk ka përfituar subvencionimin për shkak se i ka munguar ndonjë dokument të cilin kish pas mundësi që pas procesit ta sjell, do të thotë në këtë mënyrë ne kishim pas mundësi t'ju ndihmojmë atyre për të krijuar një jetë më të dinjitetshme për ta, për fëmijët dhe familjet e tyre që i mbajnë, pasi që ne jemi të informuar se më shumë se gjysma e shoqërisë tonë varet nga bujqësia. Krejt ne çka mund të bëjmë është t'ju ndihmojmë, t'i selektojmë këto familje dhe t'ju japim prioritet në këtë lloj ndihmese apo subvencionimi.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, te informata e DBPZHR-së fillimisht kisha me u ndërlihd se prapë po kemi kërkesa nga shumë bujq për dëmet që ende nuk janë kompensuar, pra të majave janar-qershor të vitit 2023 të cilët nuk kanë marrë ende kompensime dhe e kanë ngritë si shqetësim këtë çështje, andaj dua ta di nga drejtoresha e DBPZHR nëse ka informata se ku ka ngec ky proces për arsye se është bërë një kohë e gjatë. Diçka tjetër për këtë Drejtori them, pse mungojnë studimet për rënien e rendimentit, analizën e tokës bujqësore që do e ngritshin në një nivel tjetër edhe qasjen e Drejtorisë ndaj bujqësisë për arsye se të gjithë e dimë potencialin dhe kapacitetin që ka Komuna jonë e në anën tjetër kemi shumë pak analiza të tilla e që pastaj po dërgojnë te rënia e rendimentit dhe interesimit të bujqve siç ishte rasti te përfitimi i mjedrës që dëgjova se vetëm 4 fermer kanë aplikuar për të marrë subvencione për mjedër e që të gjithë e dimë çfarë interesi ka pas më herët dhe çfarë mundësish ofron Komuna jonë për këtë produkt.

Po ashtu te bletaria a është bërë ndonjë analizë e kushteve klimatike kur dihet se sektori i bletarisë si gjithë sektorët tjerë ka pas rënie në Komunën e Podujevës edhe pse duke ditur për kushtet e mira, kullosat në livadhe dhe shumë llojshmërinë e specieve mjaltëdhënëse që kemi si Komunë.

Gjithashtu nëse mundeni të na tregoni për strukturën e të mbjellave në përgjithësi në Podujevë për vitin 2023-2024, cilat janë llojet e drithërave, pemëve, perimeve që kultivohen dhe cili është

rendimenti i tyre, për arsye se nëse nuk e dimë këtë statistikë mund edhe t'i keq-orientuar subvencionet dhe mund të mos kontribuojmë në zhvillimin e këtij sektori.

Diçka për fund, te pjesa e subvencioneve kemi ankesa dhe nuk e di sa është në njohuri drejtoresha që subvencionet nuk ndahen në mënyrë korrekte gjatë thirrjeve që bëhen dhe përfituesve që marrin ku thuhet se ka ndërhyrje dhe subvencionet nuk i marrin ata që e meritojnë, nëse nuk kanë ndonjë lidhje me qeverisjen lokale.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, kam një pyetje për drejtoreshën e DBPZHR se a mund të na informosh sa gra kanë aplikuar në thirrjet të cilat ju përmendët dhe sa prej tyre janë përfituese.

**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, falënderoj drejtoreshën e DBPZHR për informatën, unë po ndalem te qëllimi kryesor i politikave bujqësore konkretisht fjalja e parë kalimi nga prodhimtaria në ferma që plotësojnë nevojat e ekonomisë familjare në gjysmë komerciale dhe në komerciale, më intereson të di qysh do bëhet ky proces, kalimi në ferma komerciale dhe gjysmë komerciale përderisa kemi kritere në konkurse për subvencione të çfarë do llojit ku një fermer duhet të ketë një sasi të krerëve të lopëve apo të serave etj etj, vetëm të ketë të drejtë dhe mundësi të aplikoj për ndonjë subvencion nga DBPZHR. Unë e pash dhe po bazohem nga të dhënat e raportit sepse raporte tjera nuk kam, i numërova të gjithë përfituesit e subvencioneve nga DBZHR, dhe nga Ministria e Bujqësisë dhe më dolën di kund 1815 përfitues kurse në raport thuhet se në total kemi 6765 fermer të regjistruar me NIF dhe me një kalkulim të thjeshtë matematikor del 27% të përfituesve, a mendon që është pak dhe a mendon që pjesa tjetër 6765 fermer është një numër shumë i ulët që të kaloj në ferma dhe në ferma gjysmë komerciale dhe komerciale në të ardhmen.

Qysh pretendon, çfarë qëllimi, çfarë projektesh ka DBPZHR për ta motivuar qytetarin Llapjan të filloj të merret me bujqësi, dhe të kemi shtim të numrit të fermerëve e jo të vazhdohet me politika të njëjta vetëm me subvencionimin e atyre që kanë, pra është mirë që ky numër të rritet, s'them që ky numër s'është rritë por është e nevojshme që ky numër të rritet më shumë me fermer të ri.

**z.Valon Demolli**, theksoi, thuajse kohën e fundit e pash një rast edhe në Klan Kosova një lloj "masakre" që kish ndodh afër burgut në fshatin Dyz ku ishte dëmtuar një plantacion i qershiave prej 2000 trupave nëse nuk gaboi, andaj e nderuar drejtoresh qysh është mundësia që të merren me prioritet subvencionimet e një rasti të tillë se ky është një rast pak më i veçantë të një qytetari të pa ndërgjegjshëm, më duket është pronari i plantacionit Albion Hoxha, si është mundësia që të subvencionohet ky fermer i dëmtuar.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, e përmendi edhe z.Arjant Topanica por po e them pak më me zë të lartë pasi që kanë kaluar këtu për Kuvend dëmet e shkaktuara edhe pse pak është bërë një lloj mashtrimi edhe prej DBPZHR. Kur i kanë mbajtur debatet me qytetarë kanë thënë që kanë filluar të bëhen pagesat, janë bërë pagesat, veç sa s'kanë dalë pagesat. Qysh jemi në dijeni ne dëmet kanë ndodh në muajin janar 2023 dhe në muajin qershor 2023 dhe tani aplikuesit po na drejtohen edhe neve sepse ne kemi votuar këtu, andaj a mund ta dimë ku qëndron problemi, a ka pas raste që Ministria ka zënë edhe asi matrapazësh dhe e kanë bllokuar procesin sepse ne duhet ta dimë një arsye pse është ndal ky proces. Ata kanë dhënë një arsye pse nuk bëhen pagesat, ata i kanë ekspertët e tyre që dalin në terren dhe i shikojnë fotografitë si dhe dalin në vendngjarje, prandaj dua ta di ku është problemi, a është problemi te DBPZHR apo në Ministri, ta dim ku qëndron problemi ngase kur ne kemi votuar këtu në Kuvend e kemi bërë shkakun i disa njerëzve që e kanë merituar edhe pse ka pas edhe të tillë që nuk e meritojnë, tani a e kanë bllokua këtë proces ata që nuk e meritojnë dhe që i kanë zënë, apo problemi qëndron diku tjetër.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, nga ajo që u tha rreth raportit të DBPZHR, u ngrit një çështje që vërtetë kemi edhe një vendim të këtij Kuvendi për dëmet e vërshimeve që kanë ndodhur dhe nga ajo çka është e vërtetë që është ekzekutuar, dëmet e janarit dhe ekonomitë familjare janë kompensuar për

dëmet që janë shkaktuar nga vërshimet, ndërsa nuk ka ndodh dëmshpërblimi për dëmet në bujqësi siç ishin në muajt janar dhe qershor e kjo njerëzve i'u ka shkaktuar një lloj hutie, dikush thotë dëmet e janarit janë kompensuar mirëpo nuk po e bëjmë një dallim që ka krijuar huti te qytetarët që këtu kemi pas dy lloj dëmsh që kanë qenë në ekonominë familjare dhe në bujqësi.

Nga ajo që ne jemi involvuar si Kuvend, e di që para se ta marrim atë vendim ndoshta edhe atëherë kemi debatuar që derisa ne nuk kemi kod buxhetor, derisa ne nuk kemi mjete të parapara për dëme atëherë ne mund të jemi një lloj servisi për një instancë më të lartë që në këtë rast fjala është për Ministrinë e Bujqësisë dhe duhet ta dinë publikisht edhe qytetarët e Komunës së Podujevës se Komuna në njëfarë forme e ka kryer obligimin e vetë çfarë i është kërkuar.

E që është kërkuar incizimi i gjendjes dhe dëmeve të shkaktuara pas vërshimeve si dhe kemi një vendim të Kuvendit për këtë.

Dëshëm apo jo, komuna sikurse të gjithë të dëmtuarit kanë pritë përgjigjen eventualisht kanë prit zhdëmtimin nga zotimi i nivelit qendror për dëmet që janë shkaktuar në Komunën tonë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kam një kërkesë, për momentin prezent jemi 13 anëtarë/e të Kuvendit andaj kërkoj nga shefat e Grupeve që t'i ftojne anëtarët e subjekteve të tyre që të jenë prezent në mbledhje të Kuvendit. Pra tani po e japim një pauzë të shkurtër 10 minuta këtu në hapësirat e Komunës derisa të arrijnë disa prej anëtarëve të Kuvendit që janë këtu afër në mënyrë që si Kuvend të vazhdojmë punimet me kuorum.

#### Konstatim:

*Në mungesë të kuorumit aktualisht, Kryesuesi i Kuvendit jep pauzë të shkurtër 10 minuta duke bërë thirrje anëtarëve të Kuvendit që të qëndrojnë këtu në hapësirat dhe ambientet e Komunës deri sa të arrijnë disa anëtarë/e të Kuvendit të cilët kanë paralajmëruar se janë duke ardhur në mbledhje.*

*Pas pauzës së shkurtër rreth 10 minuta, mbledhja vazhdoi duke filluar në ora 14:35.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, konstaton kuorumin ku prezent janë 21 anëtar/e të Kuvendit të Komunës, thekson, urdhëroni mund të vazhdojmë ku mbetëm.

**znj.Lirie Hoti**, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, sa i përket atyre aplikuesve të papunë ne me këtë ju kemi jap një përkrahje fermerëve të papunë dhe këtë ne e bëjmë në vazhdimësi, po ashtu lidhur me atë që u kërkua të pranohen dokumentet edhe pas mbylljes së afateve kjo është e rregulluar edhe me Rregulloren për subvencionimin e fermerëve kështu që diçka e tillë është e pa pranueshme, mirëpo konsideroj se jemi duke bërë një punë të mirë në këtë aspekt dhe ka hapësirë për më mirë kështu që ne ndoshta do e vendosim si kriter në projektet tjera nëse ka nevojë për këtë gjë.

Sa i përket pikave të cilat i ngriti kolegu z.Arjant Topanica për dëmet e vitit 2023, që këtë shqetësim e ngritën e edhe kolegët z.Ekrem Rrahmani dhe z.Naim Çunaku, sigurisht kjo është një çështje që diskutohet në nivel qendror dhe jo vetëm në nivel lokal, është një shqetësim që ne me të vërtetët pranojmë kërkesa dhe shqetësime të fermerëve lidhur me këtë çështje dhe e vetmja përgjigje që mund të japë në këtë fazë ku jemi ne është se të gjitha lëndët janë dërguar ashtu siç e përmendi edhe z.Ekrem Rrahmani që ato janë votuar dhe kanë kaluar përmes këtij Kuvendi, janë pranuar nga departamenti përkatës në nivelin qendror e që për fatin e mirë e kam thënë edhe njëherë që nuk është refuzuar asnjë lëndë nga Komuna e Podujevës. Komisioni e ke kryer punën e tyre dhe ne të vetmin informacion që e kemi tani është se këto pagesa kanë mbet në Thesar për tu ekzekutuar dhe se ky është një shqetësim në nivel qendror dhe jo vetëm për një komunë përkatëse.



Sa kemi ne informacion pagesa të tilla nuk janë bërë për asnjë komunë, në momentin që ne do të kemi një informacion të ri lidhur me këtë çështje apo një lëvizje të re diçka atëherë sigurisht që do të dalim me një njoftim për të gjithë fermerët tanë.

Çështje tjetër ishte pse mungojnë studimet për rënien e rendimentit dhe studimet e tokës, konsideroj që këtë vit nuk kemi pasur rënie të rendimentit, përkundrazi kemi pasur ngritje të rendimentit e sidomos në grurë, ndërsa lidhur me atë që u përmend se a kemi ne ndonjë tabelë me struktura të mbjelljeve, unë them që po kemi një tabelë me të dhëna për planifikimin dhe realizimin e mbjelljeve dhe shpenzimeve për hektar të kulturave vjeshtore të vitit 2024, tabelë kjo e punuar nga zyrtarët e DBPZHR-së në bazë të analizave që ne kemi bërë. Tani po përmendi shkurtimisht kulturat më të mbjella si gruri, elbi, thekra, por këtë tabelë të njëjtën do ua përcjell në e-mail sapo të kthehem në zyrë.

Gjithashtu lidhur me shqetësimin tuaj sa i përket rënies së interesimit për mjedër, kjo nuk ka të bëjë me Komunën sepse këtë e kemi diskutuar edhe me zyrtarët të cilët janë edhe njohës të fushës dhe këtë e kemi analizuar dhe kemi biseduar edhe me fermerët të cilët merren me kultivimin e mjedrës, realisht ata e kanë mirëpritur përkrahjen e Komunës por e thonë se problemi është te tregu e jo te Komuna dhe ajo çka po bën Komuna në përkrahjen e tyre këtë vit ata më kanë thënë se çmimi ka qenë shumë i ulët për kilogram të mjedrës edhe në vitin e kaluar kështu që kjo i ka bërë pak të hezitojnë për të investuar në mjedër dhe janë marrë me ndonjë kulturë tjetër, mirëpo kjo në asnjë moment nuk do të thotë që kjo ka qenë një ngecje e Komunës apo e Drejtorisë në përkrahjen e tyre, pra kjo nuk ka të bëjë aspak me Komunën dhe se ne e kemi bërë punën tonë më të mirë të mundshme dhe që është kërkuar në përkrahjen e fermerëve.

E njëjta vlen edhe te bletaria dhe rënia e rendimentit në mjaltë, sigurisht edhe këtë e kam diskutuar me bletarët e Llapit, kemi pas mbledhje të veçanta lidhur me këtë çështje dhe rendimenti nuk ka të bëjë me atë se ne a i përkrahim si Komunë, kjo ekskluzivisht ka të bëjë me kushtet klimatike që ne i kemi pas këtë vit sepse në fillim të vitit ne kemi pas kushtet klimatike shumë të mira madje kanë qenë shumë shpresëdhënëse që në këtë vit do të ketë një rendiment shumë të lartë të mjaltit, madje bletarët më thoshin nuk mbahet mend me vite që pritet si këtë vit të marrim rendiment por pastaj në muajin qershor ndryshimet klimatike direkt patën ndikim në bletari dhe në rendimentin e tyre, sërish e them se kjo s'ka të bëjë me Komunën, unë veçse e ceka projektin që ne e kemi realizuar dhe është projekt i realizuar me sukses.

Ankesat për subvencionet që e ceku z.Arjant Topanica se nuk po ndahen në mënyrë korrekte, unë edhe njëherë po e them që nëse din raste të tilla ose dikush ka lajmëruar ndonjë rast të tillë ju lutem deklaroni me emra dhe t'i dimë kush janë shkelësit dhe t'i trajtojmë këto raste ashtu siç thotë ligji e mos të mbesin vetëm shembuj e fjalë në ajër, ne po mundohemi maksimalisht të bëjmë përkrahjen e fermerëve dhe t'i përkrahim fermerët meritore në bazë të kriterëve që vendosim në ftesë publike si dhe në bazë të komisionëve që të thirrur të bëjnë vlerësimin në bazë të atyre kriterëve dhe të nxjerrin një listë të fermerëve fitues në bazë të kriterëve që i kanë të caktuara në ftesë publike, andaj nëse ti (i drejtohet z.Arjant Topanicës) din raste të tilla me emër e mbiemër të lutem shumë edhe njëherë adresoi në e-mailin tim apo t'i përcillmi në zyrë që t'i vërtetojmë dhe t'i shohim rastet e tilla dhe t'i japim realisht një drejtim meritore dhe ligjor.

Pyetje pranova edhe nga kolegja znj.Drita Pajaziti se sa është numri i grave të cilat kanë aplikuar, për këtë ne kemi bërë një analizë dhe kemi nxjerrë një tabelë me të gjitha projektet të cilat ne i kemi realizuar për vitin 2024, si dhe numrin e grave pjesëmarrëse në këto projekte, nëse veç keni interes unë po flas për secilën një nga një, nëse jo unë ia përcjell në e-mail koleges z.Drita Pajazitit këtë tabelë njësoj sikurse kolegut z.Arjant Topanica që e ceka pak më parë, ngase edhe për këtë ne kemi nxjerrë statistikën.

Po ashtu z.Xhevdet Maloku ngriti çështjen e fjalisë së parë të qëllimit kryesorë dhe politikave, kalimi nga prodhimi në ferma që plotësojnë nevojat e ekonomisë familjare në fermë gjysmë komerciale dhe komerciale, në vazhdimësi projektet të cilat unë i përmenda që realizohen në kuadër vjetor janë projekte që realizohen për të arrit këtë synim tonin, por edhe projektet që realizohen në Ministrinë e Bujqësisë i japin edhe një përkrahje më të fuqishme qëllimit tonë dhe unë konsideroj që në bazë të projekteve që i kemi realizuar dhe synojmë t'i realizojmë çdo vit synojmë të realizojmë këtë qëllim, nuk mund të them që këto projekte janë të njëjtat sidomos këtë vit, unë konsideroj dhe vlerësoj dhe jam shumë krenarë për atë që kemi arrit ta sjellim një ndryshim goxha të madh me subvencionim në fushën e bujqësisë.

Për të mos përsëritur projektet që i kemi pas sepse po shihen projektet që janë, vetë fakti që të mekanizmi bujqësor kemi arrit për një thirrje të japim 7 lloje të mekanizmit duke i përfshirë të gjitha grupet e fermerëve nënkupton një sukses dhe një hap tonin drejt arritjes së këtij qëllimi.

Sa i përket çështjes së aplikuesve me numrin e fermerëve aktiv, tani fermerët që i kemi cekë janë të regjistruar dhe që janë të pajisur me certifikatën e regjistrimit të fermerit është 6765 fermer, kjo shifër është marrë nga regjistrimi i fermerëve, mirëpo kjo nënkupton qysh nga dita kur ekziston ky sistem i regjistrimit të fermerëve, kjo nuk do të thotë se i kemi këta fermer aktiv sepse në vitin e kaluar në raportin e pagesave direkte i kemi pas diku rreth 2200 fermer aktiv që kanë aplikuar për pagesa direkte në Ministrinë e Bujqësisë dhe tani nëse i krahasojmë kur kemi 6765 fermer në total kurse aktiv të cilët aplikojnë në pagesa direkte kemi 2200 fermer dhe aty pari sillet edhe këtë vit numri i tyre, kjo absolutisht nuk ka të bëjë asgjë me një ngecje të Drejtorisë, fakti i interesimit që tregojnë fermerët në projektet tona nënkupton që ne kemi numër të interesuar të fermerëve dhe mua më gëzon fakti që prej se kam marrë detyrën kam takuar shumë fermere gra të interesuara, madje mund të them se sipas një statistike që kam bërë ka më shumë fermere gra që kanë ardh e janë regjistruar si fermerë se sa fermerë meshkuj dhe sidomos kanë qenë moshë të reja e kjo është diçka për t'u lavdëruar e për të bërë të lumtur.

Një çështje tjetër ishte që e ceku z.Valon Demolli i cili e përmendi dëmtimin e plantacionit të qershivë në fshatin Dyz, është e vërtetë që ne para dy ose tri dite kemi pranuar një kërkesë në DBZHR nga familja në fjalë që ju ka shkaktuar ky dëm, realisht është për keqardhje që ndodhin dëme të tilla, është për keqardhje që këto dëme shkaktohen nga faktori njeri sepse ai dëm nuk është shkaktuar nga ndonjë faktor natyror sepse i pash edhe disa foto që i kanë bashkëngjitur në lëndë dhe është për keqardhje pra, kurse tani ne si Drejtori dhe si Komunë e Podujevës do ta shohim hapësirën tonë buxhetore për përkrahje. Realisht ne nuk kemi një fond të veçantë lidhur me këtë çështje mirëpo ashtu siç jeni të informuar ne e kemi një komision që bënë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga kushtet natyrore dhe fatkeqësitë natyrore por jo nga faktori njeri, pra ky komision nuk mund të bëjë shqyrtimin e kësaj lënde mirëpo ne do të shikojmë se a kemi hapësirë buxhetore sepse natyrisht dëshira dhe vullneti jonë janë për ta ndihmuar fermerin, por do e shohim sa kemi hapësirë buxhetore dhe sigurisht që fermerit në fjalë do t'i kthejmë përgjigje.

Lidhur me atë që e cekur z.Ekrem Rrahmani për një mashtrim në proces lidhur me dëmet, i nderuar zotëri Rrahmani unë nuk do ta quaja mashtrim, madje ka qenë prononcim i imi dhe nëse njihem për diçka gjatë mandatit tim si drejtoresh e DBPZHR, ju them se për mashtrime nuk njihem, punën time e bëj me shumë sinqeritet, me shumë përkushtim dhe me vullnet të plotë për të përkrahur fermerët dhe nëse askush nuk e din këtë mendoj se e dinë dhe e dëshmojnë fermerët Llapjan të cilët janë shumë falënderues. Tani me këtë që e thash dua ta dëshmoj që s'kisha dashtë me dalë me një deklaratë të tillë kinse po mashtrohen fermerët sepse i vë në lajthitje, kjo ka qenë një informatë që e kam pas prej komisionit që e përmenda, ata më kanë japë këtë informatë dhe konsideroj se në atë periudhë edhe ata kanë pas një informatë ndoshta nga një nivel më i lartë, kështu që nëse

dikush është mashtruar i kërkoj ndjesë por kjo ka qenë informata në atë periudhë që e kemi pas për të cilën unë e bëra sqarimin se në momentin që do të kemi diçka të re dhe diçka shtesë ne do të dalim me një komunikatë publike. Unë uroj që t'ju kem dhënë një përgjigje gjitha pyetjeve tuaja dhe nëse kalova diçka ju lutem vetëm të ma rikujtoni dhe ju falënderoj shumë që e pasqyruat më tutje informatën time për këtë seancë.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, ndoshta fjala tingëllojë pak si e rëndë mirëpo unë e kam dëgjuar publikisht, shembull ta zëm dëgjimin publik pikërisht në vendlindjen e drejtoreshës në fshatin Bradash, tani fjala mashtrim ka ndodhë në varg sepse drejtoresha po thotë që Ministria na ka thënë neve këtë e ne këtë ua kemi thënë qytetarëve, por nuk është që ka mashtruar vetëm kjo por të gjithë ne pastaj. Drejtoresha i kërkoj kolegut z.Arjant Topanica që nëse ka raste t'i publikon ose t'i sjellë përmes e-mailit, kurse tani unë po t'i tregoj rastet këtu, nëse i ke vendos ti kriteret për mëshqerra që fermerët t'i kenë 1 deri në 5 krerë lopë për me marrë një mëshqerrë, unë i di 4 apo 5 fermer që kanë pasë më shumë se 10 krerë lopë dhe kanë marrë subvencion mëshqerrë, ky është vetëm një rast që e ceka e të tjerat raste nuk po dëshiroj t'i përmend.

**znj.Lirie Hoti**, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, me gjithë respektin ndaj z.Ekrem Rrahmanit, e lus që atë emër e mbiemër të ma sjellë në Drejtori sepse përndryshe ai që e din një rast të tillë po bën vepër penale sepse nuk po e paraqet një shkelje, një padrejtësi që është bërë, një shkelje të ligjit dhe kriterëve, kështu që unë i nderuar të ftoj që të ma sjellësh në Drejtori atë rast me emër e mbiemër ose edhe bëje publike qysh tani jemi të gatshëm për tu përgjigjur.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, lidhur me këtë çështje, ka shkuar një komision që ka vlerësuar dhe në qoftë se janë shkelur procedurat dhe ka pas më shumë se 10 krerë lopë dhe komisioni ka shkuar dhe i ka verifikuar, nuk është fajtor ai person por fajtor është komisioni që ia ka mundësuar.

**znj.Sebastina Vokri**, theksoi, një sqarim drejtoreshës së DBPZHR, është e vërtetë që te kriteret e aplikimit prioritet i jepet atyre të pa punësuarave por në realitet nuk po është gjithmonë ashtu sepse kur po i shohim listat nuk po janë ata persona të cilët po aplikojnë, gjithashtu edhe te dokumentacioni që u potencua është i pa pranueshëm pas procesit, jo gjithmonë është ashtu, është edhe afati për dokumente shtesë i cili mund të zbatohet pas procesit.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, vetëm po lidhem shkurt me atë që kemi numër më të madh të aplikantëve gra dhe vajzave në Llap, kjo është një gjë shumë e mirë dhe pozitive për shkak se pas një burri të suksesshëm fshihet një grua e suksesshme.

**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, meqë parafolësi kolegu filozof e përmendi aplikimin e madh të grave dhe subvencionet që përfitojnë ato, deshta ta pyes drejtoreshën e DBPZHR për ato raste a kur e keni kuptuar me komisionin verifikues kur burrat kanë përfitur përmes grave të tyre me i marrë subvencionet, e që kam dëgjuar që është praktikë e shpeshtë në Komunën e Podujevës.

**znj.Lirie Hoti**, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, atëherë për kolegen znj.Sebastina Vokri, vetëm të bëj një sqarim se në Rregulloren për subvencionim ne nuk kemi një afat të paraparë ligjor për plotësim shtesë të dokumentacionit mirëpo në momentin kur komisioni vlerësojnë për një lëndë e cila është proceduar më tutje të ketë një plotësim të një dokumentacioni përkatës këtë konsideroj që ata e bëjnë edhe pse një afat i tillë nuk është i paraparë. Ndërsa për atë që ju thoni se ne e dimë që në ftesë publike i jepet përparësi por nuk po praktikohet realisht kjo është diçka që i takon komisionit për të bërë vlerësim e që besoj që ata e respektojnë këtë kriter dhe nuk dua të besoj në atë që ju pretendoni.

Lidhur me pyetjen e znj.Donjetë Sheqiri, ne kemi kriter realisht dhe ndoshta në një seancë të radhës do të sjellë propozim për plotësim ndryshim të Rregullores për ta vendos këtë masë afirmative 5% sepse realisht ne e kemi në kriter poentimin që i japim shtesë aplikuesëve gra, ndërsa a ndodh ajo që e ceka ti ne nuk kemi një mekanizëm për ta dëshmuar sepse kërkohet

dokumentacion në bazë të Rregullores dhe në momentin që ai e sjellë realisht s'ke qysh e dokumenton a ka aplikuar burri apo gruaja kur ata jetojnë në të njëjtën shtëpi, mirëpo komisioni e bën një vlerësim shumë serioz dhe dinjitoz në bazë të kriterëve që vendosen. Unë uroj që mos të jetë ajo që u cek, dhe dua të besoj në atë që vërtetë është ngritë kjo vetëdija jonë dhe që e kemi realisht këtë pozitë dhe rol të gruas fillimisht në familje e pastaj edhe në shoqëri dhe po dua shumë me besu në këtë që ky qëllimi ynë i përkrahjes së grave vërtetë po e ka këtë suksesin që ne po e shohim dhe realisht po pretendojmë që e kemi.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, konsideroj se mundësitë për aplikim dhe malverzime janë shumë të mëdha, unë kam parë që aty përdoret edhe certifikata e bashkësisë familjare, një subvencion e merr burri tjetrin konkurron gruaja, kemi raste të tilla e që edhe këto nuk figurojnë dhe ato gjëra sigurisht që nuk i din drejtoresha sepse nuk ka mundësi, mirëpo zyra për dhënien e certifikatave të bashkësisë familjare duhet t'i jap të dhënat e kompletuara e jo të ndodh ta heq ndonjë anëtarë prej bashkësisë familjare, pra kjo është një dukuri që e kam vërejtur.

Konsideroj se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës përfunduan dhe nuk kemi më çfarë të themi sepse diskutuam mjaftueshëm, prandaj e konstatojmë të përfunduar dhe vazhdojmë me pikat e radhës të rendit të ditës.

## **7. Diskutim për parandalimin e fenomeneve negative të adoleshentëve dhe të rinjve në Komunën e Podujevës**

**z.Ragip Fetahu**, në cilësinë e propozuesit të kësaj pike, theksoi, fillimisht dëshiroj t'ju bëjë një sqarim lidhur me profesionin tim sepse unë nuk jam filozof por me profesion jam sociolog dhe jam politikolog....

**z.Naim Çunaku**, theksoi, nëse më lejohet të ndërhyjë në këtë çështje ju them se unë sakt e di që ti (i drejtohet z.Ragip Fetahut) nuk je filozof sepse filozofi ka dashuri ndaj diturisë. Këtë e them që në kuptimin sociologut të njoh andaj për ata të thash që nuk je filozof por je sociolog

**z.Ragip Fetahu**, vazhdoi, edhe pse këtë që e cekët z.Naim Çunaku unë po e marrë si ofendim por të mbetet në ndërgjegjen tuaj.

Jemi dëshmitarë të shpërfaqjes së disa fenomeneve negative të adoleshentët dhe të rinjtë në përgjithësi në nivel vendi, dhuna ndërmjet të rinjve, përdorimi i armëve të ftohta dhe të zjarrit, përdorimi i substancave narkotike janë disa prej tyre që duhet të na shqetësojnë neve si përfaqësues të qytetarëve.

Nga këto fenomene janë prekur edhe të rinjtë e Komunës së Podujevës e këtë e vërtetojnë edhe të dhënat zyrtare të Policisë së Kosovës ku deri sa në vitin 2023 kishim 83 raste të rrahjeve dhe lëndimeve në nivel të përgjithshëm në Komunën tonë, në vitin 2024 ky numër bie për 62, por nëse i analizojmë këto të dhëna në aspektin e grup moshës na rezulton se kemi rritje të rasteve të dhunës së raportuar të moshës nën 18 vjeçare. Në vitin 2023 ishin të paraqitura 11 raste të dhunës të moshës nën 18 vjeçare ku dominon grup moshë 14 dhe 16 vjeçare me 6 raste konfliktuoze, ndërsa në vitin 2024 ky numër është rritur për 13 raste ku 8 nga to janë të grup moshës 14 dhe 16 vjeçare, por sigurisht që ky numër mund të jetë edhe më i lartë duke u bazuar në atë se ende ekziston mungesa e kulturës së raportimit në organet përkatëse si dhe traditës së zgjidhjes së konflikteve përmes ndërmjetësimin.

Po ashtu kemi edhe rritje të përdoruesve të armëve të ftohta dhe të zjarrit e që sipas Policisë në vitin 2023 në Komunën e Podujevës ishin 75 raste të armëmbajtjes pa leje ku 11 nga to ishin të

moshës nën 18 vjeçare, ndërsa në vitin 2024 kemi 104 raste të tilla nga to 12 raste janë të moshës nën 18 vjeçare.

Gjithashtu në Komunën tonë kemi rritje të numrit të qytetarëve të cilët me vete posedojnë substanca narkotike e që përderisa në vitin 2023 sipas raportit të Policisë së Kosovës ishin 25 raste që me vete bartnin substanca të tilla të ndaluara, në këtë vit deri tani kemi 34 raste të raportuara. Janë disa faktorë që nxisin të rinjtë të merren me këto fenomene negative duke filluar nga familja, ndryshimet e shpejta në mënyrën e të jetuarit, përndërimi i pakontrolluar i internetit e që me këtë aludojmë në tik-tok-un e deri te rrethi shoqëror.

Neve pra na takon që të diskutojmë dhe të japim rekomandime për mënyrën e zgjidhjes së këtyre problemeve, e Komuna e Podujevës me Drejtorinë e saj dhe në bashkëpunim edhe me organet tjera përkatëse duhet të marrë masa konform rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, kurse disa nga masat të cilat unë propozoj që duhet të merren janë si vijon;

-Uniformat edhe në shkolat fillore nga Klasa e V-të e tutje,

-Kontrollet e vazhdueshme rutinore nëpër shkolla, e që vlen të theksohet fakti që Policia e Kosovës gjatë këtij vitit ka bërë mbi 2000 kontrolle në rreth shkollave të Komunës së Podujevës ku ka gjetur pra armë të zjarrit dhe armë të ftohta,

-Trajtim ligjor dhe psikologjik i të rinjve problematik si dhe shtimi i stafit lokal duke përfshirë këtu psikolog dhe punonjës social në përputhej me ligjin për familjen dhe ligjin për mbrojtjen e fëmijës,

-Fushata informuese më të detajuara,

-Projekte konkrete në fushën e rinisë, nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit si dhe Bashkëpunim dhe koordinim më të madh me OJQ-të reale që veprojnë në Komunën tonë,

-Përkrahje më e madhe e projekteve konkrete gjatë tërë vitit në fushën e rinisë si dhe matja e rezultateve të tyre, pra jemi dëshmitar të asaj që ka një numër të madh të projekteve në Komunën tonë dhe në nivel lokal që jepen për OJQ-të lokale mirëpo nuk bëhet matja e rezultateve se sa ato projekte kanë qenë të efektshme në terren, gjë që është mangësi dhe duhet të përmirësohet,

-Respektimi i ligjit duke i'u kufizuar qasjen e të rinjve dhe adoleshentëve në blerjen e duhanit dhe alkoolit,

-Trajtimi i familjeve prej nga vijnë të rinjtë problematik, nga Qendra për Punë Sociale,

-Organizime dhe aktivitete rekreative sportive me qëllim të mundësimit të shkarkimit të energjisë së të rinjve, pra kërkoj nga Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit të ndërmarrin sa më shumë aktivitete si dhe të koordinohen sa më shumë mes vete në mënyrë që të ketë sa më shumë aktivitete rekreative sportive për të rinjtë në mënyrë që ata të kenë mundësinë që energjitë e akumuluaru rinore t'i derdhin me aktivitete tjera në koordinim duke u bazuar në koordinimin e drejtorive të cekura.

Dhe është detyrë e shenjtë e Komunës së Podujevës që të punoj sa më shumë në ndërtimin e një shoqërie të shëndosh pa dhunë, pa armë dhe pa substanca narkotike.

Më lejon që për fund t'i falënderoj Policinë e Kosovës-Stacionin Policor të Podujevës për bashkëpunimin dhe ofrimin e të gjitha informatave që ata posedojnë për këto fenomene negative.

Pres nga Ju të nderuar kolegë që natyrisht të jepni secili që ka dëshirë kontributin e juaj në këtë çështje dhe të gjithë së bashku të punojmë për një të ardhme më të mirë të rinisë tonë.

**znj. Donjetë Sheqiri**, theksoi, unë jashtëzakonisht e përshëndes idenë e kolegut parafolës për të diskutuar për gjendjen në fjalë dhe për këto dukuri për arsye se është mjaft shqetësuesi për Komunën e Podujevës, mirëpo me mirëkuptimin e partive tjera këtu në Kuvend kërkoj që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës për arsye se personat kyç mungojnë, drejtori i Drejtorisë së Arsimit nuk është këtu, drejtoresha e Kulturës Rinisë dhe Sportit nuk është këtu, prandaj për seancën e

ardhshme të përgatiten dhe të jenë këtu prezent si dhe edhe neve si asamble të na vie një raport i detajuar lidhur me këto fenomene në mënyrë që diskutimi tamam ta ketë rëndësinë e vet.

Pra nëse ka mundësi, po besoj që edhe me mirëkuptimin e kolegut z.Ragip Fetahu si iniciues i kësaj pike ta shtyjme për seancën e radhës.

**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, siguria në shkolla është përgjegjësi morale e të gjithëve dhe përgjegjësi institucionale ligjore e Komunës, policisë dhe akterëve tjerë.

Siguria në shkolla, mbrojtja nga abuzimi dhe krimet kibernetike, pastaj fenomenet negative siç janë droga, duhani, alkooli dhe ajo që kohëve të fundit është në rritje bullizmi, duhet parandaluar dhe unë mendoj që është mirë sot të diskutohet kurse në seancat tjera të ardhshme mund të marrim edhe masa tjera bashkërisht me Ministrinë e Arsimit dhe me akterët tjerë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, në rend të parë nëse kolegu z.Ragip Fetahu ka mendoi që unë pata qëllim për ofendim, të jeni i bindur që jo he se ajo që e ceka ishte më shumë në kuptimin e shakasë, prandaj nëse e konsideron si ofendim atëherë unë të kërkoj falje sepse nuk e kam pas atë qëllim kur u bisedua specifikisht për profesionin e që sërish e them se nga ajo që unë di ti je sociolog andaj edhe e thash që nuk je filozof, kuptimi i filozofisë ishte ajo që e thash dashuria ndaj shkencës dhe diturisë.

Sa i përket temës, vërtetë nga të dhënat që i dëgjova prej kolegut z.Ragip Fetahu, sa janë të dhëna të mira nuk munda të jem indiferent ngase janë të dhëna shqetësuese për drejtimin/kahjen se ku jemi duke shkuar si shoqëri. E di që shoqëria Llapjane nuk mund të jetë e izoluar prej trendit të zhvillimeve shoqërore si në Kosovë ashtu edhe më tutje, mirëpo fundja sa herë e them që ne këtu jemi që të përfaqësojmë qytetarët Llapjan dhe të ngrisim shqetësimet që rëndojnë jetën dhe problemet e Llapit dhe me të vërtetë ato të dhëna që dëgjova nga z.Ragip Fetahu nuk më bëjnë të jem indiferent si dhe duke pasë parasysh edhe propozimin e koleges znj.Donjetë Sheqiri vërtetë ne ndoshta do të bëjmë sot një debat por të përgjysmuar në kuptimin që të paktën ato të dhëna që posedonte zotëri Fetahu t'i ndanit me neve si dhe ta kishim një materialin më të zgjeruar dhe kjo krejt me qëllimin e dhënies së kontributit për ngritjen e këtyre shqetësimeve gjegjësisht hulumtimit të alternativave që sa më pak të vijnë në shprehje këto dukuri devijante për të cilat deri në një masë kemi qenë në dijeni por jo në atë trend të zhvillimit çfarë ju i paraqitët dhe që përmende.

Kur të propozohet një pikë e rendit të ditës dhe që nuk e kemi materialin përcjellës ne sot nëse veç vazhdojmë, mund të debatojmë dhe të kërkojmë nga ti zotëri Fetahu një deklaratë të cilën mund ta harmonizosh edhe me Grupet tjera që të dalim në fund me propozime konkrete të inkorporuara në atë deklaratë për udhëzime të mëtutjeshme për gjendjen dhe për alternativa për dalje nga kjo, mirëpo në momentin çfarë jemi ne sot nuk di që mund të japim ndonjë kontribut tjetër përpos që ta ndajmë shqetësimin me ty zotëri Fetahu.

Të mos keqkuptohem me kolegen znj.Donjetë Sheqiri por që vërtetë ndoshta kjo temë kaq e rëndësishme dhe kaq jetike nuk do të duhej të kalonte si e trajtuar sepse nga ato të dhëna që i paraqiti zotëri Fetahu mendoj që duhet të jetë një trajtim tjetër dhe shumë më serioz dhe me gjithë akterët që janë këtu siç janë informatat e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, informatat e Stacionit të Policisë, informatat e Drejtorive përkatëse, dhe kur ta kemi të kompletuar me të dhëna të bollshme sigurisht se do të kërkonim edhe alternativa për të dal sa më pak të ken vend në shoqërinë tonë këto dukuri devijante.

Edhe njëherë i nderuar z.Ragip Fetahu të përgëzoj për këtë iniciativë, por jo e përgatitur sa duhet për neve si Kuvend i Komunës që një iniciativë shumë e qëlluar që do të duhej të merrte vëmendje jo vetëm të neve kuvendarëve.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, vetëm një sugjerim, unë po e shoh që Kuvendi është shumë i interesuar të debatohet për këtë temë mirëpo Kuvendi nuk është i informuar kështu që unë do të kërkoja një kompromis prej z.Ragip Fetahut që të na jepet mundësi ta shtyjme këtë pikë të rendit të ditës për mbledhjen e radhës, të jetë pikë e rregullt dhe t'ju shpërndahet materiali të gjithë anëtarëve të Kuvendit dhe pastaj të diskutojmë dhe të bëjmë plotësimet e nevojshme sipas mundësive tona, pra nëse është i pajtimit edhe iniciuesi i kësaj pike z.Ragip Fetahu.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, falënderoj parafolësit për kontributin e dhënë, e para, pika që unë kam kërkuar të jetë pikë e rendit të ditës këto diskutime do të ishte mirë të bëheshin në fillim të mbledhjes, pra para se të hyjë si pikë në rend të ditës.

E dyta, çështja tjetër është se qëllimi i kësaj pike të rendit të ditës është thjesht nxitja e debatit dhe dhënia e rekomandimeve se çka duhet të bëjë Ekzekutivi i Komunës për këtë, gjë që të dyja këto të plotësohen në atë që e thash unë në qoftë se kolegët e Kuvendit të Komunës dëshirojnë unë mund t'jua dërgoj materialin përmes e-mailit dhe secili prej neve në qoftë se ka ndonjë rekomandim konkret ose ndonjë masë konkrete parandaluese, ose që ka ndonjë ide konkrete lidhur me këto probleme, natyrisht se mund t'i bëjë duke thirrur një seancë e që edhe unë do të jap kontributin tim në këtë çështje.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, vetëm dua të sqaroj atë që parafolësi z.Ragip Fetahu e tha për fillim të seancës, mirëpo kur të propozohet një pikë e rendit të ditës aty nuk ka debat, këtë kuptojë, kushdo që propozon ndonjë pikë për të hyrë në rend të ditës nuk ka debat, kjo është me rregullativë ligjore, kështu që anëtarët e Kuvendit në fillim kur ti e propozove nuk kanë pas të drejtë të debatohet, prandaj tani po debatohet dhe po e shohë një interesim për këtë temë.

Pra nuk kemi pas të drejtë të debatohet ne se a ta fusësh apo jo si pikë e rendit të ditës, ti e propozove dhe ne e votuam që të hyjë pikë e rendit të ditës dhe tani po debatohet dhe asgjë e keqe nuk ndodhi, madje po shohim një interesim për të debatuar për këtë temë por që u propozua të debatohet më gjerësisht në një mbledhje të radhës, sigurisht që të përgatiten edhe anëtarët e kuvendit qoftë edhe me materialin tuaj i nderuar zotëri Fetahu, plus edhe që të jenë prezent edhe drejtorët e Drejtorive që u përmenden, kështu që unë do ta hedhja në votim këtë propozim që të shtyhet për një mbledhje të radhës kjo pikë e rendit të ditës.

Pra i nderuar Ragip Fetahu mendoj se u sqaruar, neve por sigurisht edhe ty po na konvenon që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, nëse e shtyjme këtë pikë të rendit të ditës për mbledhjen e radhës, mund ta bëjmë por me një ide konkrete se çka tutje.

**Kryesuesi i Kuvendit**, duke sqaruar parafolësin theksoi, pika e njëjtë do të vije i nderuar por edhe materiali do t'ju dërgohet anëtarëve të Kuvendit.

**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, dëshiroj ta specifikoj edhe njëherë propozimin tim, nga zyra juaj i nderuar Kryesues të kërkohet prej Policisë, prej drejtorive të shkollave, nga Këshilli Komunal për siguri në Bashkësi, një raport të veçantë për këto dukuri dhe të na sjellët në Kuvend neve si asambleistë në mënyrë që në seancën e radhës të diskutojmë me fakte dhe argumente.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, unë po besoj se janë të interesuar të kyçen edhe shumë faktor tjerë relevant në këtë çështje.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, plotësisht pajtohem me idenë e shumicës së asambleistëve që e potencuan se është mirë që zotëri Fetahu e a sjellë pikë të rendit të ditës këtë temë, mirëpo ne shumica prej neve këto informata që u paraqiten nuk i kemi pas.

Nëse drejtori i Drejtorisë së Arsimit nuk është këtu prezent, pastaj drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës Rinis dhe Sportit, Kryetari i Komunës, madje unë propozoj që prezent kur të debatohet kjo temë të jetë edhe Komandanti i Stacionit të Policisë, të bëhen diskutimi, të kemi informatat e

nevojshme he ne të marrim një qëndrim ose një dakordim se çfarë masash duhet të ndërmarim, pra të ketë diçka më kuptimplotës dhe diçka më të qartë rreth kësaj çështje sepse për të debatuar dhe të mbetet në letër unë nuk jam i interesuar por unë jam i interesuar të diskutojmë me gjithë akterët dhe të japim zgjidhje diçka, kështu që unë mendoj se më mirë është ta shtyjmë për seancën e radhës këtë pikë, është ide e qëlluar dhe thjesht të jemi të gjithë më të përgatitur.

**z.Haki Rudari**, theksoi, dëgjova kolegët dhe propozimet e dhëna dhe ajo që e potencoj kolegu është shumë e arsyeshme për arsye se ka të bëjë me dukuritë negative tek të miturit deri në moshën 16-17 vjeçare. Problemet janë të shumta nëpër shkolla, afër shkollave, rrugëve e të tjera që i përmendi kolegu z.Ragip Fetahu e që nuk po dua të marrë më shumë kohë sepse iniciativa, përgatitja dhe të gjitha të tjerat janë të zotëri Fetahut, prandaj po e them se si ide dhe si propozim ka qenë shumë mirë dhe domosdoshëm, ndërsa për formën se si dëshirojmë të veprojmë do të doja ta përfundon sërish iniciuesi i kësaj pike.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, këtu po shihet se qëllimi është më i miri që kjo pikë të diskutohet edhe me nivele edhe më të larta. Ti zotëri Fetahu je iniciator.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, megjithatë informacionet e Policisë i kam që mi kanë dërguar të gjitha statistikave por duke u bazuar në atë insistimin e të gjithëve që ishte që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës pra edhe unë jam i pajtimit që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës, mirëpo kam shumë qejf dhe dëshirë që të nxjerrim diçka më të re dhe diçka më konkrete të gjithë së bashku në mënyrë që t'i kontribuojmë qytetit, të rinjve tanë dhe qytetarëve në përgjithësi.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, faleminderit për mirëkuptimin e juaj i nderuar z.Ragip Fetahu, qëllimi ishte i mirë dhe kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e radhës në mënyrë që në mbledhjen e radhës të konstatojmë edhe nga faktorët tjerë relevant siç u cekën Drejtoria e Arsimit, Policia, Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, të cilat mund të kyçen në këtë projekt sepse po besoj se është një projekt i cili ka një rëndësi shumë të madhe, andaj sa për procedurë e hedh në votim.

*Konstatim:*

*Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 21 vota Për nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, mbështet propozimi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës në mënyrë që të dërgohet materiali përkatës i përgatitur nga hulumtimi i z.Ragip Fetahut dhe që në mbledhjen e radhës konstatimet të bëhen edhe në bazë të të dhënave të prezantuara nga Drejtoritë dhe sektorët tjerë relevant lidhur me këtë çështje.*

## **8. Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht zëvendësimi i anëtarit pas dhënies së dorëheqjes së z.Qëndrim Softolli**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës e cila hyri si pikë shtesë në fillim të kësaj mbledhje kemi të bëjmë me zëvendësimin e një anëtari të Komitetit për Politikë dhe Financa pas dhënies së dorëheqjes së Qendrim Softolli nga të qenit anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, respektivisht anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pra z.Qendrim Softolli ka qenë anëtar nga radhët e LDK-së dhe duhet të zëvendësohet me një anëtar nga radhët e këtij subjekti politik, andaj urdhëroni mund ta merrni fjalën.



**z.Valon Demolli**, theksoi, pra siç e dim kolegu z.Qendrim Softolli ka dhënë dorëheqje nga cilësia e anëtarët të Kuvendit të Komunës, andaj përbërjen e Komitetit për politikë dhe Financa do ta zëvendësojmë me z.Ekrem Rrahmanin.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën apo nëse ka ndonjë propozim tjetër, nëse jo atëherë e hedh në votim propozimin që z.Ekrem Rrahmani ta zëvendësoj z.Qendrim Softolli,

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 21 anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 14 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan) miratohet propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Komitetit për Proklitikë dhe Financa, përkatësisht z.Ekrem Rrahmani emërohet anëtar i këtij Komitet duke zëvendësuar z.Qendrim Softollin i cili ka dhënë dorëheqje nga funksioni anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urime z.Ekrem Rrahmani prej mbledhjes së ardhshme je anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa.

## 9. Të Ndryshme

**znj.Edona Shabani**, theksoi, do të doja t'i drejtohem drejtorit të Drejtorisë së Arsimit mirëpo qysh më duket nuk është duke i'u bërë von as atij sepse ashtu siç e potencoj edhe një koleg i imi tani është fushata zgjedhore. Pra nuk e di drejtori i Drejtorisë së Arsimit a ka apo jo informacione që fëmijët me nevoja të veçanta që 6 javë nuk janë duke mbajtur mësim për shkak të transportit, ndërsa ai në një mbledhje të kaluar dilte aty në foltore dhe u lavdërojke duke më thënë mua që nëse dëshiron të kapi për dore dhe të dërgoj në shkollën e fshatit Gllamnik dhe të shohim qysh funksionojnë, mirëpo ai po harron që atyre fëmijëve qoftë e edhe 24 orë po t'iu humben janë shumë e lëre më 6 javë

Çështja tjetër është se prindërit e tyre jeni duke i stresuar me këtë punë që nuk janë duke u marrë me fëmijët me aftësi të kufizuara, andaj unë i kërkoj drejtorit të drejtorisë së Arsimit që këtë punë ta merre pak sa më serioze ngase nuk është numër i madh i tyre për të mos mund t'iu bëhet zgjidhje, dhe ka mundësi për t'iu bërë zgjidhje. E them këtë edhe për fatin që ai një diskutim e pati filluar duke thënë që kemi psikolog, sociolog e gjëra tjera, por ai po harron që psikologët dhe sociologët duhet të jenë të punësuar aty ku ka fëmijë/nxënës e jo të marrin paga pa lidhje, kështu që këtë diskutim timin do të doja ta shoh dhe dëgjoj drejtori në fjalë.

Po ashtu do të koka që edhe kamera të fokusohet nga pjesa e Ekzekutivit të Komunës ku shihet që përveç drejtorit të DPZHE asnjë tjetër nuk është prezent aty, përndryshe postet këtyre askush me zor nuk jua ka dhënë por ato i kanë pranuar me shumë qejf. Pastaj e them se kur ne po ju parashtrijmë pyetje atyre asgjë personale nuk e kemi me ata mirëpo kur po i'u tregojmë se janë gabim për diçka ata po na gjuhen ne ve në personale. Prandaj ju lus i nderuar Kryesuesi i Kuvendit ashtu qysh na lute ti neve të qëndrojmë këtu në sallë, të lusësh edhe ata të qëndrojnë në sallë deri në përfundimin e mbledhjes.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, më vie keç që kam harruar t'ju njoftoj se drejtori i Drejtorisë së Arsimit dje më ka lajmëruar se nuk mund të jetë prezent sot për shkak se është në një konferencë në Tiranë, mirëpo besoj se do ta dëgjoj këtë dhe do t'ju jep përgjigje lidhur me pyetjet e juaja.

**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, natyrshëm që edhe unë i bashkëngjitëm shqetësimit të koleges parafolëse sa i përket mungesës së drejtorëve të drejtorive, përveç drejtorit të DPZHE z.Vigan Salihu i cili është këtu prezent. Këtë e them për arsye se edhe pyetjet pastaj nuk po kemi ku t'i drejtojmë. Si do qoftë unë dua të shpreh një shqetësim lidhur me transportin publik në fshatin Dumnicë për arsye se nga muaji qershor nuk ka transport publik dhe kjo pastaj po shpie në parregullsi, nxënësit po vonohen në shkollë dhe duhet ta ketë parasysh edhe drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit që transporti publik për në Dumnicë lidh 4 fshatra përreth andaj të paktën 3 herë apo me 3 relacione të punoj. Prandaj kërkoj që të ndërmerren hapa sa më shpejt për arsye që banorët edhe më herët kanë kërkuar nga Komuna edhe privatisht për një gjë të tillë mirëpo nuk po bëhet asgjë në këtë drejtim.

**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, e vlerësoj dhe përgëzoj drejtorin z.Vigan Salihu që është duke qëndruar dhe duke na respektuar edhe neve si Kuvend.

Unë në fakt kisha pyetje për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit të cilës nga muaji qershor kur i kam parashtruar një pyetje këtu në Kuvend më ka thënë që do të më përgjigjet në e-mail, mirëpo boll shumë e njoh teknologjinë dhe kam hulumtuar mos rastësisht ka mbërrirë në ndonjë folder andej këndeje, por askund në e-mail nuk më ka ardhur përgjigje, andaj e kërkoja fjalën thash rastësisht mos po e sheh këtë seancë dhe po ma gjen e-mailin diqysh.

**znj.Tringa Sfishta**, theksoi, drejtoresha e DSHMS-së si duket doli jashtë mirëpo unë për atë pyetje, fjala është për një shqetësim i cili posa na erdhi i cili paska dalë edhe nëpër media që autoambulancat e QKMF-së janë momentalisht pa goma të dimrit dhe pa regjistrim, kështu që deshta shpjegim prej drejtoreshës mirëpo nuk qenka prezentë.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, kam dy pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, njëra ka të bëjë me deponinë e mbeturinave të shkolla e fshatit Sfeçël gjë kjo që ndoshta është e katërta apo e pesta herë e që vazhdimisht marrë shqetësime nga banorët e fshatit Sfeçël për atë deponi e cila vazhdimisht mbushet me mbeturina jo organike, do të thotë mbeturina të shtëpive të dëmtuara kurse tani kanë filluar të hedhin edhe mbeturina organike gjë që shkakton edhe kundërmim edhe grumbullim të qenve endacak aty ku është ngjitur me rrethojat e shkollës, për më shumë unë këtu i kam edhe fotot por tani drejtori përkatës nuk është këtu prezent. Pra kam bërë disa herë kërkesë për largimin e asaj deponie por që nuk ka ndërmarrë kurrfarë përgjigje e as kurrfarë veprimi.

Po ashtu edhe tek ura në afërsi të lagja "Vokrollët" çështje kjo po ashtu që kanë kaluar rreth 2 vite që janë rrënuar njëra anë e rrethojave të urës ku vazhdimisht kalojnë fëmijët/nxënësit andej nga shtëpitë në shkolla dhe anasjelltas e që janë në pyetje 3- 4 metra në njërin anë të rrugës dhe ende ashtu në at gjendje qëndron, edhe për këtë i kam fotot por që nuk po i nxjerr fare meqë drejtori përkatës veç se nuk është prezent këtu.

Gjithashtu kemi edhe prishjen e asfaltit nga kompania e ujësjellësit e që në njërin anë e fshatit janë sanuar dëmet e bëra nga kompania e ujësjellësit kurse në anën tjetër të fshatit ende ka pjesë të prera të asfaltit të shkaktuara nga kompania e ujësjellësit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sa i përket mbeturinave që i ceku parafolësi z.Arjant Topanica të cilat i paskeni bërë ju vet mendoj se fajet i paskeni ju vet si fshat dhe mendoj se janë mbeturina tuajat dhe këtë problem si bashkëfshatar është mirë ta zgjidhni ju vet. ndërsa për këto tjerat nuk kam përgjigje.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, grumbullimi i atyre mbeturinave kanë filluar si bartje e fshatrave përreth, e për këtë është në dijeni edhe drejtori i DSHPMSh sepse e kemi diskutuar këtu, fundja është edhe përgjegjësi dhe detyrë e DSHPMSh për mirëmbajtjen e hapësirave publike sepse ajo pjesë është hapësirë publike. Prandaj përgjigjen e deshta prej drejtorit të Drejtorisë në fjalë e jo prej teje i nderuar Kryesues i Kuvendit, edhe pse ti po ke përgjigje për gjithçka.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, në rastet kur mbeturinat hedhen nëpër lagje dhe nëpër oborre të shkollave, unë fillimisht ju fajësoj juve si banorë, ju i bëni ato, përndryshe e them se askush para shtëpisë time nuk vie dhe ti hedh mbeturinat para shtëpisë time.

**znj.Tringa Sfishta**, theksoi, vetëm një sqarim rreth fjalimit tim të mëhershëm e që reagoi drejtoresha e DSHMS, atëherë vetëm deshta t'ju tregoj se fjalët që i ceka unë sapo i vërtetoi edhe portali Nacionale, kështu që ju ftoj t'i shikoni.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, edhe unë pata pyetje për Stacionin e Autobusëve, mirëpo me që drejtori i Drejtorisë përkatëse nuk po e them dhe nuk po e zgjati më tepër.

Po ashtu shfrytëzoj rastin të falënderoj ata që më përkrahën për anëtar në Komitetin për Politikë dhe Financa.

*Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 15:25**

**Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;**

**Enis Sheholli**

**Osman Bajrami**

**Nr.Prot.01-060/04-0078828/24**

**Podujevë,**

**11 dhjetor 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Hilmi Hoxha**